						Njësia Administrative nr. 12	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrative nr. 13	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrative nr. 14	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Rinas	Rinas, Domje
						Petrelë	Petrelë, Mullet, Stërmas, Picall, Shënkoll, Gurrë e Madhe, Gurrë e Vogel, Daias, Barbas, Fikas, Mangull, Qeha, Shytaj, Hekal, Kryezi, Percëllesh, Durishtë
						Farkë	Farkë e Madhe, Farkë e Vogël, Lundër, Mjull Bathore, Sauk, Selitë
						Dajt	Linzë, Shishtufinë, Tujan, Brrar, Ferraj, Priskë e Madhe, Surrel, Lanabreges, Shkallë, Qafmollë, Darshen, Selbë, Murth
						Zall-Bastar	Zall-Bastar, Bastar i Mesëm, Bastar–Murriz, Vilëz, Zall-Mner, Mner i Sipërm, Bulçesh, Zall Dajt, Besh, Dajt, Shëngjin i Vogël, Selitë Mali
						Bërzhitë	Ibë, Bërzhitë, Dobresh, Ibë e Poshtme, Pëllumbas, Mihajas-Cirmë, Kus, Fravesh, Kllojkë, Pashkashesh, Lugë-Shalqizë, Rozaverë
						Kërrabë	Krrabë, Mushqeta, Skuterë
						Baldushk	Baldushk, Mumajes, Fushas, Balshaban, Shpatë, Isufmuçaj, Mustafakoçaj, Koçaj, Kakunj, Vesqi, Parret, Shënkoll, Vrap, Shpat i Sipërm
						Shëngjergj	Shëngjergj, Verri, Urë, Burimas, Shëngjin, Façesh, Bizë, Fage, Parpujë, Vakumone, Domje, Derje
						Vaqarr	Vaqarr, Allgjatë, Arbanë, Bulticë, Damjan-Fortuzaj, Gropaj, Lalm, Prush, Vishaj, Sharrë
						Kashar	Kashar, Yzberish, Mëzez, Yrshek, Katundi i Ri, Kus, Mazrek
						Pezë	Pezë e Madhe, Pezë Helmës, Pezë e Vogël, Varosh, Maknor, Dorëz, Gror, Grecë, Pajanë, Gjysylkanë
						Ndroq	Ndroq, Zbarqe, Kërçukje, Zhurje, Lagje e Re, Pinet, Sauqet, Çalabërzezë, Shesh, Grebllesh, Mënik
						Zall-Herr	Zall-Herr, Dritas, Çerkezë-Morinë, Qinam, Kallmet, Herraj, Pinar, Priskë e Vogël, Radhesh
			Vorë	Vorë	Vorë	Vorë	Qyteti Vorë, Vorë, Marqinet, Shargë, Gërdec, Gjokaj, Kuc, Marikaj, Picar
						Prezë	Prezë, Ahmetaq, Palaq, Fushë Prezë, Gjeç-Kodër, Ndërmjetës, Breg-Shkozë
						Bërxullë	Bërxullë, Mukaj


QARKU VLORË


Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e qarkut	Bashkia	Qendra e bashkisë	Qyteti	Njësia administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
XII	Vlorë	Vlorë	Delvinë	Delvinë	Delvinë	Delvinë	Qyteti Delvinë, Bamatat, Vllahat, Rusan, Lefterhor, Kakodhiq, Sopot, Stjar, Vanë, Blerimas
						Vergo	Vergo, Tatzat, Kalasë, Fushë Vërri, Senicë, Kopaçez, Qafë Dardhë, Bajkaj
			Finiq	Fshati Dermish	Finiq	Livadhja	Livadhja, Kulluricë, Llazat, Kalcat, Kodër, Lefter Talo, Gravë, Qesarat, Komat, Karroq, Grazhdan, Zminec, Sopik, Pandalejmon, Vagalat
						Dhivër	Dhivër, Rumanxë, Memoraq, Navaricë, Dermish, Leshnicë e Sipërme, Leshnicë e Poshtme, Janicat, Llupsat, Cerkovicë, Shëndre, Malcan
						Aliko	Aliko, Çaush, Neohor, Tremul, Rahullë, Pllakë, Jermë, Vurgu i Ri, Halo, Dritas
						Finiq	Finiq, Buronjë, Çlirim, Vrion, Karahaxhë, Bregas
						Mesopotam	Mesopotam, Dhrovjan, Krongj, Bistricë, Velahovë, Livinë, Brajlat, Sirakat, Kostar, Fitore, Krane, Ardhasovë, Kardhikaq, Pecë, Muzinë
			Himarë	Himarë	Himarë	Himarë	Qyteti Himarë, Pilur, Kudhës, Qeparo fshat, Qeparo Fushë, Vuno, Iliaz, Dhërmi, Gjilekë, Palasë
						Lukovë	Lukovë, Borsh, Fterrë, Çorraj, Piqeras, Sasaj, Qazim Pali, Shënvasil, Nivicë
						Horë-Vranisht	Vranisht, Kuç, Kuç Buronjë, Bolenë, Kallarat, Tërbaç
			Konispol	Konispol	Konispol	Konispol	Qyteti Konispol, Çiflik
						Xarrë	Xarrë, Mursi, Shkallë, Vrinë, Shëndëlli
						Markat	Dishat, Vërvë, Shalës, Markat, Ninat, Janjar
			Sarandë	Sarandë	Sarandë	Sarandë	Qyteti Sarandë, Gjashtë, Metoq, Çukë, Shelegar
						Ksamil	Ksamil
			Vlorë	Vlorë	Vlorë	Vlorë	Qyteti Vlorë
						Qendër Vlorë	Bestrovë, Babicë e Madhe, Babicë e Vogël, Hoshtimë, Kaninë, Kërkovë, Nartë, Sherishtë, Panaja, Xhyherinë, Zvërnec, Sazan
						Novoselë	Novoselë, Aliban, Bishan, Mifol, Poro, Dëllenjë, Delisuf, Trevllazër, Cerkovinë, Skrofotinë, Fitore, Akërni
						Shushicë	Shushicë, Bunavi, Beshisht, Grabian, Drithas, Mekat, Llakatund, Çeprat, Risili
						Orikum	Qyteti Orikum, Dukat, Dukat Fshat, Tragjas, Radhimë
						Selenicë	Qyteti Selenicë
						Armen	Armen, Karbunarë, Rromës, Treblovë, Lubonjë, Picar, Mesarak
						Vllahinë	Vllahinë, Kocul, Mërtiraj, Rexhepaj, Hadëraj, Mallkeq, Gërnec, Petë, Kropisht, Vezhdanisht, Peshkëpi, Penkovë
						Kotë	Kotë, Gumenicë, Hysoverdhë, Lapardha, Mavrovë, Mazhar, Vajzë, Vodicë, Shkallë Mavrovë, Drashovicë
						Sevaster	Sevaster, Golimbas, Dushkarak, Shkozë, Mazhar, Ploçë, Lezhan, Amonicë
						Brataj	Brataj, Lepenicë, Gjorm, Velçë, Ramicë, Mesaplik, Matogjin, Bashaj, Vërmik, Malas


HARTA ADMINISTRATIVE TERRITORIALE E QARQEVE TË SHQIPËRISË






HARTA ADMINISTRATIVE TERRITORIALE E BASHKIVE TË SHQIPËRISË
N
W
E
S
MALËSI E MADHE
TROPOJË
HAS
SHKODËR
PUKË
VAU-DEJËS
KUKËS
LEZHË
MIRDITË
DIBËR
KURBIN
MAT
KRUJË
BULQIZË
DURRËS
VORË
KAMEZ
SHIJAK
TIRANË
LIBRAZHD
KAVAJË
PEQIN
ELBASAN
LUSHNJË
POGRADEC
GRAMSH
PUSTEC
KUÇOVË
FIER
ROSKOVEC
BERAT
KORÇË
DEVOLL
MALLAKASTËR
SKRAPAR
VLORË
TEPELENË
KOLONJË
PËRMET
HIMARË
GJIROKASTËR
DELVINË
DROPULL
SARANDË
FINIQ
KONISPOL
Shpjegues
Kufijt e Bashkive
Qytetet
Kufij Njesi Administrative
1:900,000
0 5 10 20 30 40
Kilometers



QARKU BERAT
ELBASAN
KORÇË
FIER
GJIROKASTËR
BERAT
KUÇOVË
POLIÇAN
ÇOROVOD
DIMAL
SKRAPAR
1:230,000
Kilometers
0 4 8 16
Shpjegues
Kufi Bashki
Kufi Njësi Administrative
QYTETI
BERAT
DIMAL
KUÇOVË
POLIÇAN
ÇOROVOD



QARKU DIBËR
SHKODËR
KUKËS
LEZHË
ELBASAN
TIRANË
DIBËR
KASTRIOT
PESHKOPI
MAQELLARË
SHUPENZË
BULQIZË
MARTANESH
BURREL
KLOS
MAT
ULËZ
1:240,000
Kilometers
0 4 8 16
Shpjegues
Kufi Bashki
Kufi Njësi Administrative
QYTETI
BULQIZË
BURREL
KASTRIOT
KLOS
MAQELLARË
PESHKOPI
SHUPENZË
ULËZ
MARTANESH



QARKU DURRËS
DIBËR
LEZHË
TIRANË
KRUJË
FUSHË-KRUJË
DURRËS
SHIJAK
1:150,000
0 2.5 5 10 Kilometers
Shpjegues
Kufi Bashki
Kufi Njësi Administrative
QYTETI
DURRËS
FUSHË-KRUJË
KRUJË
SHIJAK



QARKU ELBASAN
DIBËR
KORÇË
TIRANË
DURRËS
BERAT
ELBASAN
LIBRAZHD
PRRENJAS
PEQIN
GRAMSH
BELSH
CËRRIK
1:300,000
Kilometers
0
5
10
20
Shpjegues
Kufi Bashki
Kufi Njësi Administrative
QYTETI
BELSH
CËRRIK
ELBASAN
GRAMSH
LIBRAZHD
PEQIN
PRRENJAS



QARKU FIER
ELBASAN
BERAT
GJIROKASTËR
VLORË
TIRANË
KOR
1:280,000
Kilometers
0 4.75 9.5 19
Shpjegues
Kufi Bashki
Kufi Njësi Administrative
QYTETI
BALLSH
DIVJAKË
FIER
LUSHNJË
PATOS
ROSKOVEC



QARKU GJIROKASTËR
KORÇË
BERAT
FIER
VLORË
GJIROKASTËR
DROPULL
LIBOHOVË
PËRMET
KËLCYRË
TEPELENË
MEMALIAJ
1:310,000
Kilometers
0
5
10
20
Shpjegues
Kufi Bashki
Kufi Njësi Administrative
QYTETI
DROPULL
GJIROKASTËR
KËLCYRË
LIBOHOVË
MEMALIAJ
PËRMET
TEPELENË



QARKU KORÇË
ELBASAN
BERAT
GJIROKASTËR
FIER
KORÇË
PUSTEC
DEVOLL
BILISHT
POGRADEC
MALIQ
ERSEKË
KOLONJË
1:430,000
Kilometers
0 5 10 20
Shpjegues
Kufi Bashki
Kufi Njësi Administrative
QYTETI
BILISHT
ERSEKË
KORÇË
MALIQ
POGRADEC
PUSTEC


QARKU KUKËS
Shpjegues
Kufi Bashki
Kufi Njësi Administrative
QYTETI
HAS
KUKËS
BAJRAM CURRI
1:320,000
0 5 10 20
Kilometers
SHKODËR
LEZHË
DIBËR
KUKËS
HAS
TROPOJË
BAJRAM CURRI


QARKU LEZHË
SHKODËR
KUKËS
DIBËR
DURRËS
MIRDITË
LEZHË
RRËSHEN
KURBIN
LAÇ
MAMURRAS
MILOT
RUBIK
SHËNGJIN
1:210,000
0 3.5 7 14 Kilometers
Shpjegues
Kufi Bashki
Kufi Njësi Administrative
QYTETI
LAÇ
LEZHË
MAMURRAS
RRËSHEN
MILOT
SHËNGJIN
RUBIK


QARKU SHKODËR
Shpjegues
Kufi Bashki
Kufi Njësi Administrative
QYTETI
DUKAGJIN
FUSHË ARRËZ
KOPLIK
PUKË
SHKODËR
VAU-DEJËS
VELIPOJË
BUSHAT
KASTRAT
KUKËS
LEZHË
1:350,000
Kilometers
0
5
10
20


QARKU TIRANË
DIBËR
ELBASAN
DURRËS
FIER
TIRANË
KAMËZ
KAVAJË
RROGOZHINË
VORË
GOLEM
Shpjegues
Kufi Bashki
Kufi Njësi Administrative
QYTETI
1:210,000
Kilometers
0
3.5
7
14


QARKU VLORË
ELBASAN
KORÇË
BERAT
GJIROKASTËR
FIER
1:430,000
Kilometers
0 5 10 20
Shpjegues
Kufi Bashki
Kufi Njësi Administrative
QYTETI
DELVINË
FINIQ
HIMARË
KONISPOL
ORIKUM
SARANDË
SELENICË
VLORË

DEKRET
Nr. 580, datë 31.10.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 100/2026, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 103/2026

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 431, DATË 9.6.2011, "PËR MBROJTJEN E MJEDISIT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 19 bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Pas shkronjës "b", të pikës 1, shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) restaurimin e elementeve të natyrës.".

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Masat përkatëse për restaurimin e natyrës, sipas shkronjës "c", të pikës 1 të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin.".

Neni 2

Pas nenit 55 shtohet neni 55/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 55/1
Certifikimi i largimit të karbonit

1. Ministria u jep certifikatën e largimit të karbonit, si një shenjë dalluese dhe njohjeje, personave fizikë e juridikë të cilët gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre dhe prodhimit të produkteve largojnë, mbledhin e depozitojnë karbonin në produkte sipas kritereve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin, miraton kriteret, procedurën dhe kërkesat për pajisjen me certifikatën e largimit të karbonit, mënyrën e dhënies, përdorimit dhe vlefshmërisë së saj, përbërjen dhe funksionimin e komisionit për lëshimin e certifikatës, mënyrën e aplikimit e të procedurës për dhënien e certifikatës, të referuar në pikën 1 të këtij neni.".

Neni 3

Në kreun X bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1.Titulli i seksionit 1 ndryshohet si më poshtë:

"Institucionet përgjegjëse".

2. Pas nenit 58 shtohet neni 58/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 58/1
Ministria përgjegjëse për mjedisin

Ministria përgjegjëse për mjedisin është organ qendror politikëbërës e koordinues në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe ka, por pa u kufizuar në to, këto detyra:

a) zbaton parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, për secilin nga përbërësit e mjedisit dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në bashkëpunim me të gjitha autoritetet publike dhe publikun;

b) harton e paraqet për miratim pranë Këshillit të Ministrave strategjitë dhe planet mjedisore kombëtare për secilin nga përbërësit e mjedisit;

c) lëshon lejet, licencat dhe autorizimet e nevojshme në fushën e mjedisit, në përputhje me

legjislacionin në fuqi për lejet, licencat e autorizimet dhe ligjet specifike sektoriale në fushën e mjedisit;

ç) mbështet financiarisht projektet që ndihmojnë zhvillimin e fushës së mjedisit.".

3. Shkronja "g", e pikës 1, të nenit 60 shfuqizohet.

4. Titulli i seksionit 3 ndryshohet si më poshtë:

"Mbështetja financiare për projektet në fushën e mjedisit".

5. Neni 67 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 67
Fondi kombëtar i mjedisit

1. Fondi kombëtar i mjedisit krijohet në formën e një fondi financiar publik që mbështet politikën kombëtare të mbrojtjes së mjedisit.

2. Burimet e financimit të fondit kombëtar të mjedisit, janë:

a) buxheti i shtetit;

b) financime vendase apo të huaja për këtë qëllim.

3. Fondi kombëtar i mjedisit krijohet pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe administrohet sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Mbështetja financiare e dhënë nëpërmjet fondit kombëtar të mjedisit, sipas këtij ligji, jepet në formën e granteve, subvencioneve ose instrumenteve të tjera të mbështetjes financiare për realizimin e projekteve dhe veprimtarive në fushën e mjedisit.".

Neni 4

Pas nenit 67 shtohen nenet 67/1, 67/2 dhe 67/3 me këtë përmbajtje:

"Neni 67/1
Financimi i projekteve dhe i veprimtarive në fushën e mjedisit

1. Ministria përgjegjëse për mjedisin financon nga fondi kombëtar i miratuar çdo vit:

a) projekte të paraqitura nga organizata jofitimprurëse dhe individë që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre fushën e mjedisit;

b) projekte dhe veprimtari në fushën e mjedisit, që kanë një buxhet që arrin mbi 50% të fondit vjetor për projekte;

c) projekte dhe veprimtari të ideuara e të propozuara nga vetë ministria përgjegjëse për mjedisin, si dhe agjencitë e varësisë në fushën e mjedisit.

2. Për realizimin e projekteve dhe të veprimtarive në fushën e mjedisit, skema e financimit mbulon deri në 100% të kostove të miratuara të projektit.

3. Procedurat e kriteret që ndiqen për financimin e projekteve, sipas shkronjës "b", të pikës 1 të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 67/2
Miratimi i projekteve dhe i veprimtarive në fushën e mjedisit nga ministria përgjegjëse për mjedisin

1. Miratimi i projekteve dhe i veprimtarive në fushën e mjedisit bëhet nga ministri përgjegjës për mjedisin, me propozimin e komisionit të përbërë nga 5 nëpunës të administratës publike të nivelit të lartë e të mesëm, drejtues të strukturave përgjegjëse që mbulojnë fushën e mjedisit në ministrinë përgjegjëse për mjedisin, të cilët përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin.

2. Kriteret dhe afatet, në lidhje me kërkesëpropozimet për mbështetje financiare, të parashikuara në shkronjat "a" dhe "c", të pikës 1, të nenit 67/1 të këtij ligji, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 67/3
Kompetencat e komisionit të përzgjedhjes së projekteve

1. Komisioni ka këto kompetenca:

a) përzgjedh dhe klasifikon projektet bazuar në parimet e mbrojtjes, të ruajtjes e të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;

b) harton dhe i propozon ministrit përgjegjës për mjedisin veprimtari e projekte në fushën e mjedisit në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 67/1 të këtij ligji.

2. Mënyra e funksionimit të komisionit përcaktohet në rregulloren e miratuar nga ministri përgjegjës për mjedisin.".

Neni 5

Në nenin 71 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas fjalës "neneve" shtohen fjalët "19, pika 3";

b) Pas fjalëve "55, pika 6" shtohen fjalët "55/1, pika 2";

c) Fjalët "67, pika 2" zëvendësohen me fjalët "67, pika 3, 67/1, pika 3".

2. Në pikën 2, fjalët "të nenit 50, pika 4" zëvendësohen me fjalët "të neneve 50, pika 4, 67/2, pika 2, e 67/3, pika 2".

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa efektet financiare të tij fillojnë nga data 1 janar 2027.

Miratuar në datën 9.10.2026.

Shpallur me dekretin nr. 581, datë 31.10.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 581, datë 31.10.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 103/2026, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011, 'Për mbrojtjen e mjedisit', i ndryshuar".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM
Nr. 22, datë 20.10.2026

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË KONTRATAVE PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË RIPOPULLIMIT, PESHKIMIT, TË PESHKIMIT NË UJËRAT E BRENDSHME DHE TË AKUAKULTURËS NË SIPËRFAQE TOKËSORE DHE UJORE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 16/1, të vendimit nr. 712, datë 31.1.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim përcakton rregullat dhe procedurën për monitorimin e kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe të akuakulturës në sipërfaqe tokësore dhe ujore, me qëllim përmirësimin e mekanizmave të monitorimit përmes një procesi të unifikuar dhe të dokumentuar, duke garantuar trajtim të barabartë të të gjitha kontratave objekt monitorimi.

2. Monitorimi i kontratave synon:

a) Sigurimin e zbatimit të detyrimeve kontraktore dhe ligjore nga subjektet fizikë ose juridikë (në vijim "subjekte"), që kanë lidhur kontratë me ministrinë përgjegjëse për aktivitetin e peshkimit dhe akuakulturës (në vijim "ministria") për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për ushtrimin e aktivitetit të ripopullimit të peshkimi;

b) Identifikimin, dokumentimin dhe vlerësimin e rasteve të mosrespektimit të detyrimeve kontraktore dhe ligjore;

c) Marrjen e masave administrative, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e peshkimit dhe akuakulturës, si dhe me detyrimet ligjore që burojnë nga kontrata, ndaj subjekteve kontraktore që konstatohet se kanë shkelur kushtet kontraktore ose ligjore.

3. Monitorimi i kontratave kryhet nga struktura përgjegjëse për monitorimin e kontratave të peshkimit dhe akuakulturës në ministri (në vijim "struktura përgjegjëse"), në bashkëpunim me institucionin përgjegjës për inspektimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës, i cili për kryerjen e monitorimit të çdo kontrate vendos në dispozicion një inspektor, si dhe të dhënat dhe procesverbalet e kontrolleve të kryera nga inspektorët e peshkimit. Kontratat e lidhura me njësitë e vetëqeverisjes vendore monitorohen nga struktura përgjegjëse pranë bashkisë përkatëse.

4. Struktura përgjegjëse ndjek në vijueshmëri përmbushjen dhe respektimin e detyrimeve dhe kushteve të kontratës, për këtë qëllim ajo mban dhe përditëson regjistrin e kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit dhe të akuakulturës bazuar, në:

a) aktet e monitorimit dhe inspektimit;

b) raportimet e subjektit;

c) vendimmarrjet administrative të ministrisë.

5. Për çdo kontratë të lidhur, ministria i dorëzon një kopje edhe institucionit përgjegjës për inspektimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për çdo kontratë të lidhur, njoftojnë ministrinë përgjegjëse për peshkimin.

II. PROCEDURA E MONITORIMIT TË KONTRATAVE

1. Monitorimi i kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës bëhet në mënyrë periodike, sipas planit të miratuar, të paktën një herë në vit, nga struktura përgjegjëse.

2. Planet e monitorimit përgatiten nga struktura përgjegjëse dhe miratohen nga ministri ose kryetari i bashkisë përkatëse.

3. Monitorimi mund të kryhet edhe pa planifikim, në rastet kur ka indicie apo dyshime për shkelje, të mbështetura në ankesa, informacione nga subjekte private, institucione shtetërore apo nga verifikime në terren.

4. Monitorimi ka për objekt verifikimin, e:

a) Realizimit të investimeve ndër vite dhe sipas zërave të deklaruar në kontratë dhe planbiznesin e paraqitur nga subjektet në konkurrimin publik për të fituar të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të peshkimit/akuakulturës, si dhe nga subjektet që kanë fituar të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës në zonë tokësore private;

b) Respektimit të nivelit të punësimit;

c) Realizimit të sasisë së deklaruar të prodhimit dhe sasisë së zënieve;

ç) Zënieve/kultivimit sipas llojeve, sasisë dhe metodologjisë së përcaktuar në planbiznes;

d) Raportimit të deklarimeve statistikore dhe pagesës së detyrimeve financiare (taksa vjetore);

dh) Respektimit të sipërfaqes ujore/koordinatave të përcaktuara në kontratë;

e) Përdorimit të bazës materiale dhe mjeteve të deklaruara për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit/akuakulturës.

5. Procesi i monitorimit zhvillohet në këto faza:

5.1 Planifikimi dhe njoftimi:

a) hartimi dhe miratimi i planit të monitorimit;

b) njoftimi i subjektit të paktën 5 (pesë) ditë kalendarike përpara, duke përcaktuar dokumentacionin që duhet të paraqesë dhe afatin për dorëzimin e tij.

5.2 Monitorimi në terren:

a) Kontrolli i realizimit fizik të investimeve. Këto investime mund përfshijnë ndërtimet që shërbejnë për kultivimin e organizmave ujorë, të tillë si: vaskat, kanalet furnizuese dhe shkarkuese, inkubatorët, laboratorët, magazinat frigoriferike, si dhe çdo ndërtim apo investim tjetër që shërben për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës, si dhe atë të peshkimit (varka, rrjeta peshkimi etj.), sipas treguesve të deklaruar në kontratë apo planbiznes, pjesë integrale e kontratës;

b) Kontrolli i përputhshmërisë së sipërfaqes ujore dhe/ose koordinatave të përcaktuara në kontratë;

c) Verifikimi i përdorimit të bazës materiale dhe mjeteve të peshkimit, sipas parashikimeve të bëra në planbiznes;

ç) Hartimi dhe mbajtja e procesverbalit të monitorimit, ku evidentohen gjetjet dhe konstatimet gjatë kontrollit në terren; procesverbali nënshkruhet nga palët përkatëse dhe subjekti kontraktor.

5.3 Shqyrtimi i dokumentacionit:

a) Analiza e dokumentacionit ekonomik/financiar dhe ligjor. Ky dokumentacion përfshin:

i. faturat tatimore (blerje), që vërtetojnë realizimin e investimeve sipas zërave dhe viteve të deklaruara në kontratë dhe planbiznes;

ii. fatura tatimore (shitje) të produkteve peshkore që subjektet duhet të zejnë/kultivojnë sipas llojeve, sasisë dhe metodologjisë së përcaktuar në planbiznes;

iii. leje ndërtimi, kontrata sipërmarrjeje, porosie ose dokumente të tjera ligjore që vërtetojnë ligjshmërinë e ndërtimeve apo investimeve të tjera të parashikuara në planbiznes, të shoqëruara me fatura tatimore që provojnë pagesën e shërbimeve për realizimin e tyre. Ndërtimet apo investimet e tjera, të parashikuara në planbiznes, duhet të jenë në funksion të ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës/peshkimit, objekt kontrate;

b) Kontroll dhe verifikim i numrit të deklaruar të punonjësve përmes shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (deklarata të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, vërtetime të pagesave të kontributeve, regjistri i punonjësve, listëpagesat mujore etj.);

c) Shqyrtim i raportimeve statistikore mbi të dhënat për zënien/kultivimin, për të verifikuar përputhshmërinë e të dhënave të raportuara me gjetjet faktike.

5.4 Analiza dhe raportimi:

a) Hartimi i raportit paraprak të monitorimit;

b) Evidentimi i shkeljeve (nëse ka) me referencë në dispozitat përkatëse ligjore dhe kontraktore.

5.5 E drejta për t'u dëgjuar:

a) Njoftimi i subjektit për gjetjet;

b) Dhënia e një afati prej 7 (shtatë) ditësh kalendarike për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare.

5.6 Vendimmarrja administrative:

a) Shqyrtimi i pretendimeve përfundimtare;

b) Hartimi i raportit përfundimtar, i cili evidenton shkeljet e konstatuara, si dhe rekomandimet dhe propozimet për masat përkatëse, me referencë në dispozitat ligjore dhe kontraktore në fuqi; sipas rastit, raporti përfshin masa për përmirësim, duke përcaktuar afate të qarta dhe të arsyeshme për përmbushje ose propozon zgjidhjen e kontratës kur shkeljet janë të natyrës që e justifikojnë këtë masë;

c) Miratimi i raportit nga ministri ose kryetari i bashkisë i shoqëruar, në rast se propozohet zgjidhja e kontratës, me urdhrin përkatës për zgjidhjen e saj;

ç) Njoftimi i subjektit për masën e marrë.

6. Shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit ekonomik/financiar dhe ligjor kryhet brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e paraqitjes së dokumentacionit përkatës nga subjekti kontraktor. Në rastin e OMP-ve, shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit ekonomik/financiar dhe ligjor kryhet brenda një afati prej 30 ditësh kalendarike.

7. Raporti përfundimtar i monitorimit të çdo kontrate hartohet brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike nga data e përfundimit të afatit të caktuar në pikën 6 të këtij kreu.

8. Në raste të veçanta, për shkak të volumit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti ose kur natyra dhe kompleksiteti i çështjeve të konstatuara kërkojnë kohë shtesë për analizë dhe verifikim, afatet e përcaktuara në pikat 6 dhe 7 të këtij kreu mund të zgjaten për një periudhë shtesë, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.

9. Në kategoritë ujore të shpallura si zona bashkëmenaxhimi ku funksionojnë Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit (OMP), struktura përgjegjëse dhe institucioni përgjegjës për inspektimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës monitorojnë zbatimin e kushteve të kontratës që ministria ka lidhur me OMP-në përkatëse dhe të planit të bashkëmenaxhimit. Procesi i monitorimit kryhet sipas pikës 5 të këtij kreu.

III. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet struktura përgjegjëse për monitorimin e kontratave të peshkimit dhe akuakulturës në ministri ose në njësinë e vetëqeverisjes vendore, si dhe institucioni përgjegjës për inspektimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës.

2. Udhëzimi nr. 6, datë 10.4.2026, "Për përcaktimin e procedurës së monitorimit të zbatimit të kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe të akuakulturës në sipërfaqe tokësore dhe ujore", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 1092, datë 27.10.2026

PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENIN E OHRIT DHE GRUMBULLIMIN E VEZËVE TË KORANIT PËR INKUBIM

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, "Për peshkimin", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe ndalimin e mbajtjes në bord, tranzitimin në barkë dhe zbarkimin e qëllimtë të belushkës *(Salmothymus ohridanus),* në liqenin e Ohrit, prej datës 1.11.2026 deri më datë 1.3.2027.

2. Ndalimin e peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe ndalimin e mbajtjes në bord, tranzitimin në barkë dhe zbarkimin e qëllimtë të të gjitha llojeve të peshqve në liqenin e Ohrit, prej datës 1.12.2026 deri më datë 1.3.2027, me përjashtim të tratave të zallit (vlagë) për gjuetinë e cironkës *(Alburnus alburnus alborella),* sipas zonave bregliqenore të përcaktuara nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

3. Çdo mjet gjuetie peshku i kapur nga organet e monitorimit dhe të kontrollit gjatë kohës së ndalimit të gjuetisë së peshkut të sekuestrohet.

4. Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA) të koordinojë veprimtarinë organizative, teknike dhe financiare me Qendrën e Prodhimit të Rasateve të Koranit në fshatin Lin të Pogradecit, për gatishmërinë e marrjes së vezëve të koranit *(Salmo letnica),* shtrimit dhe trajtimit të tyre për inkubim.

5. Për periudhën prej 1.1.2026 deri më 1.3.2027 të lejohet vetëm peshkimi i riprodhuesve të koranit *(Salmo letnica)* për qëllime të grumbullimit të vezëve deri në 220 kg, të cilat do të shtrohen për inkubim në impiantet e Qendrës së Prodhimit të Rasateve të Koranit, në fshatin Lin të Pogradecit.

6. Shpenzimet e pagesës së materialit biologjik (vezëve), karburantit që shpenzohet për grumbullimin dhe transportimin e vezëve të koranit dhe shpenzimet e tjera që kanë të bëjnë me këtë aktivitet do të mbulohen nga buxheti i planifikuar i DSHPA-së.

7. Veprimtaria e grumbullimit të vezëve, të kryhet e organizuar nën drejtimin e DSHPA-së, në varësi të së cilës është Sektori i Kontrollit dhe Monitorimit të Peshkimit, Qendra e Prodhimit të Rasateve të Koranit në fshatin Lin të Pogradecit, të cilët bashkëpunojnë me 60 peshkatarë me përvojë.

8. DSHPA-ja, nëpërmjet Qendrës së Prodhimit të Rasateve të Koranit në fshatin Lin të Pogradecit, të lidhë kontratë me peshkatarët, për mbledhjen dhe dorëzimin e vezëve të koranit, të ndara sipas zonave specifike buzë liqenit.

9. DSHPA-ja, në bashkërendim me Drejtorinë e Politikave, Strategjisë dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës të hartojë një plan veprimi të detajuar dhe të miratuar prej tyre.

10. Ngarkohen Drejtoria e Politikave, Strategjisë dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Qendra e Prodhimit të Rasateve të Koranit në fshatin Lin të Pogradecit të bashkëpunojnë me strukturat e qeverisjes vendore Pogradec, Komisariatin e Policisë, Policinë Tatimore, Drejtorinë Rajonale të AKU-së Korçë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 1106, datë 29.10.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E HOLANDËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
b) zogjve 24-orësh;
c) shpendëve dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezëve të shpendëve;
dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*
1	Noord-Holland	Zeevang*
2	Groningen	Grootegast*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 1107, datë 29.10.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E LITUANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Lituanisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Kauno	Kėdainių*	
Kauno	Prienų*	
Klaipedos	Kretingos*	
Klaipedos	Skuodo*	
Klaipedos	Šilutės*	
Marijampoles	Marijampolės*	
Marijampoles	**Šakių***	
Marijampoles	Vilkaviškio*	
Šiauliai	Kelmės*	
Šiauliai	Šiaulių*	
Taurages	Tauragės*	
Telšiai	Mažeikių*	
Utenos	Molėtų*	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të

kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 1018, datë 6.10.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Lituanisë", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

VENDIM
Nr. 12, datë 29.10.2026

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT GJYQËSORE GJATË SHQYRTIMIT TË ÇËSHTJEVE TË JURIDIKSIONIT DISIPLINOR

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar,

në datën 29.10.2026, mori në shqyrtim projektrregulloren "Për procedurat gjyqësore gjatë shqyrtimit të çështjeve të juridiksionit disiplinor".

Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenin 13, shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për procedurat gjyqësore gjatë shqyrtimit të çështjeve të juridiksionit disiplinor", sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese për zbatimin dhe ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 29.10.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji
Anëtarë: Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Marsida Xhaferllari, Asim Vokshi, Marjana Semini, Sonila Bejtja.

RREGULLORE
PËR PROCEDURAT GJYQËSORE GJATË SHQYRTIMIT TË ÇËSHTJEVE TË JURIDIKSIONIT DISIPLINOR

Në mbështetje të nenit 1, pika 2, si dhe nenit 13, shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Mbledhja e Gjyqtarëve miraton rregullat e procedurave gjyqësore gjatë shqyrtimit të çështjeve të juridiksionit disiplinor, për sa vijon:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të sigurojë ushtrimin efektiv të juridiksionit disiplinor fillestar dhe rishikues nga ana e Gjykatës Kushtetuese nëpërmjet

përcaktimit të procedurave dhe rregullave të detajuara procedurale, duke garantuar respektimin e parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe të të drejtave të pjesëmarrësve në gjykim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 2
Objekti

1. Objekt i kësaj rregulloreje janë rregullat për paraqitjen, regjistrimin, administrimin e dokumentacionit, veprimtarinë këshillimore, ndihmëse dhe procedurale gjyqësore gjatë ushtrimit të juridiksionit disiplinor fillestar dhe rishikues nga Gjykata Kushtetuese, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni.

2. Gjykata Kushtetuese ushtron juridiksion disiplinor fillestar, lidhur me përgjegjësinë disiplinore të:

i. anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

ii. anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

iii. Prokurorit të Përgjithshëm;

iv. Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

3. Gjykata Kushtetuese ushtron juridiksion disiplinor rishikues për ankimet, kundër:

i. vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, lidhur me shkeljen disiplinore të një gjyqtari ose në rastet e tjera të parashikuara në ligj;

ii. vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, lidhur me shkeljen disiplinore të një prokurori ose në rastet e tjera të parashikuara në ligj;

iii. vendimit të Komisionit të Posaçëm Disiplinor të ngritur në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me të cilin vendoset një masë disiplinore ndaj inspektorit;

iv. vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose mbylljen e hetimit ndaj anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

4. Rregullat e përcaktuara në këtë rregullore gjejnë zbatim si për juridiksionin disiplinor fillestar, ashtu edhe atë rishikues, me përjashtim të rasteve kur vetë kjo rregullore parashikon ndryshe.

5. Për çështjet procedurale që nuk rregullohen shprehimisht nga kjo rregullore, zbatohen ligjet e tjera që janë në fuqi, për aq sa ato janë të pajtueshme me natyrën dhe veçoritë e juridiksionit disiplinor fillestar dhe rishikues.

Neni 3
Parimet e ushtrimit të juridiksionit disiplinor fillestar dhe rishikues

1. Gjykata, në ushtrimin e juridiksionit disiplinor fillestar, udhëhiqet dhe synon zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të procedimit disiplinor, si vijon:

a) të drejtën për një proces të rregullt, duke përfshirë edhe marrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm;

b) parimin e ligjshmërisë;

c) parimin e barazisë përpara ligjit;

ç) parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin e dyshimit në favor të subjektit të procedimit disiplinor;

d) parimin e proporcionalitetit;

dh) parimin e drejtësisë së hapur;

e) parimin e konfidencialitetit dhe të drejtën e jetës private, si dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Në balancimin e parimit të drejtësisë së hapur, parimit të konfidencialitetit, së drejtës për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Gjykata merr parasysh veçanërisht:

a) faktin që të garantohet mbrojtja e integritetit dhe dinjitetit të subjektit të proceduar nga akuzat e pabaza;

b) rëndësinë që ka informimi i publikut në lidhje me akuzat e provuara në funksion të administrimit të drejtësisë.

3. Këto parime, për sa janë të pajtueshme, zbatohen edhe për juridiksionin disiplinor rishikues.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Ankues" është subjekti i legjitimuar sipas ligjit që paraqet ankim përpara Gjykatës Kushtetuese kundër një vendimi që i nënshtrohet juridiksionit disiplinor rishikues.

2. "Arkivim administrativ" është veprimi procedural me anë të të cilit Drejtoria e Përgjithshme Gjyqësore dhe e Dokumentacionit vendos të arkivojë kërkesën/ankimin sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000.

3. "Dosje disiplinore" është tërësia e akteve, dokumenteve, provave dhe vendimeve të

administruara gjatë procedimit disiplinor nga organi kompetent, përfshirë aktet e hetimit dhe të shqyrtimit disiplinor, si dhe vendimin përfundimtar që i nënshtrohet juridiksionit disiplinor rishikues të Gjykatës Kushtetuese.

4. "Dosje e hetimit" është tërësia e akteve, dokumenteve, provave dhe materialeve të mbledhura ose të administruara gjatë hetimit disiplinor nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, përfshirë raportin përfundimtar të hetimit dhe aktet që mbështesin kërkesën për procedim disiplinor.

5. "Juridiksion disiplinor fillestar" është juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin dhe vendimmarrjen për përgjegjësinë disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

6. "Juridiksion disiplinor rishikues" është juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve disiplinore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Komisionit të Posaçëm Disiplinor të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose mbylljen e hetimit, sipas rasteve të përcaktuara në këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

7. "Kërkues" është subjekti i legjitimuar sipas ligjit që paraqet përpara Gjykatës Kushtetuese kërkesën për procedimin disiplinor, që i nënshtrohet juridiksionit disiplinor fillestar.

8. "Raport i hetimit" është akti i përgatitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas përfundimit të hetimit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

9. "Subjekt i interesuar":

a) në juridiksionin disiplinor fillestar është subjekti për të cilin kërkohet shqyrtimi i përgjegjësisë disiplinore, sipas rastit, anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

b) në juridiksionin disiplinor rishikues është organi që ka marrë vendimin objekt ankimi, sipas rastit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Komisioni i Posaçëm Disiplinor ose Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si dhe subjektet e tjera që kanë interes të drejtpërdrejtë në çështje, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU II
PARAQITJA E KËRKESËS/ANKIMIT DHE SHQYRTIMI PARAPRAK

Neni 5
Paraqitja e kërkesës/ankimit

1. Në rastin e juridiksionit disiplinor fillestar kërkesa për procedimin disiplinor sipas pikës 2 të nenit 2 të kësaj rregulloreje paraqitet me shkrim, nga:

a) Inspektori i Lartë i Drejtësisë për anëtarin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për anëtarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe për Prokurorin e Përgjithshëm;

b) Komisioni Hetimor i Kuvendit për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

2. Kërkesa për procedimin disiplinor paraqitet, sipas rastit, bashkë me raportin e hetimit dhe dosjen e plotë hetimore, si dhe çdo akt tjetër që ka shërbyer për të mbështetur kërkesën.

3. Në rastin e juridiksionit disiplinor rishikues, ankimi, sipas pikës 3, të nenit 2 të kësaj rregulloreje, si rregull, paraqitet me shkrim nga gjyqtari, prokurori ose inspektori, ankuesi dhe/ose nga përfaqësuesi i tyre me prokurë të posaçme, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë rregullore, dhe duhet të përmbajë:

a) emrin dhe adresën e Gjykatës Kushtetuese;

b) emrin, mbiemrin ose emërtimin, vendbanimin ose vendqëndrimin e ankuesit dhe/ose të përfaqësuesit, si dhe të dhënat elektronike të kontaktit të tyre;

c) emrin, mbiemrin ose emërtimin, vendbanimin ose vendqëndrimin e subjekteve të interesuara dhe/ose të përfaqësuesve, si dhe të dhënat elektronike të kontaktit të tyre;

ç) objektin e kërkesës/ankimit dhe bazën ligjore;

d) parashtrimin e shkaqeve të kërkesës/ankimit dhe shkeljet e pretenduara;

dh) dokumentet, provat ose materiale të tjera që shoqërojnë kërkesën/ankimin ose provojnë fakte me rëndësi për shqyrtimin e kërkesës/ankimit;

e) kopjen e njësuar me origjinalin të vendimit objekt ankimi;

ë) nënshkrimin e kërkuesit ose të përfaqësuesit të tij, si dhe aktin e përfaqësimit të këtij të fundit.

4. Në rastin e juridiksionit disiplinor rishikues ankimi paraqitet brenda 4 muajve nga njoftimi i aktit.

5. Kërkesa/ankimi paraqitet në Gjykatë dorazi ose nëpërmjet shërbimit postar. Kur kërkesa/ankimi paraqitet me postë elektronike (*email*), ajo duhet të jetë e nënshkruar elektronikisht, sipas legjislacionit në fuqi. Kur kërkesa/ankimi paraqitet pa nënshkrim elektronik, kërkuesi njoftohet për plotësimin e kësaj kërkese dhe për depozitimin e kopjes fizike brenda afatit 10-ditor. Në rast të mosplotësimit të kërkesave të mësipërme brenda afatit, kërkesa/ankimi arkivohet.

6. Për dokumentimin, regjistrimin dhe administrimin e kërkesave, ankimeve dhe vendimeve që lidhen me juridiksionin disiplinor fillestar dhe rishikues mbahen regjistra të posaçëm, të miratuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve.

7. Si datë e paraqitjes së kërkesës/ankimit në regjistrin përkatës shënohet:

a) data e depozitimit fizikisht në Gjykatë, në rastin kur akti paraqitet personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur nga subjekti përkatës;

b) data e depozitimit në Gjykatë nga shërbimi postar, në rastin kur akti është dërguar nëpërmjet shërbimit postar. Në këtë rast, për efekt të respektimit të afatit të ankimit, llogaritet data e depozitimit në postë;

c) data e mbërritjes në adresën elektronike zyrtare të Gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për komunikimin dhe dokumentin elektronik.

8. Palët dhe pjesëmarrësit në gjykim kanë detyrimin të paraqesin të dhënat elektronike të kontaktit (numër telefoni/adresë postë elektronike), për efekt të marrjes dijeni për njoftimet nga Gjykata. Adresa fizike e njoftimit të palëve, kur ato e kanë absolutisht të pamundur paraqitjen e të dhënave elektronike të kontaktit, konsiderohet ajo e përcaktuar në kërkesë/ankim ose adresa e përfaqësuesit, nëse ka të tillë.

9. Në rast se palët nuk dëshirojnë që të dhënat e tyre të bëhen publike duhet të paraqesin një kërkesë që tregon arsyet për përjashtimin nga ky rregull, të dhënat që nuk duhet të bëhen publike, si dhe mënyrën e anonimizimit të këtyre të dhënave.

Neni 6

Pranimi dhe kontrolli administrativ i kërkesës/ankimit

1. Drejtoria e Përgjithshme Gjyqësore dhe e Dokumentacionit verifikon nëse kërkesa/ankimi përmban elementet formale dhe dokumentet shoqëruese të nevojshme, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

2. Ajo përgatit një listë kontrolluese të dokumenteve shoqëruese dhe ndihmon palët, nëse kërkesa/ankimi paraqitet dorazi, duke u shpjeguar se çfarë mungon nëse kërkesa është e paplotë.

3. Kur kërkesa/ankimi nuk plotëson elementet formale, ajo konsiderohet e paplotë dhe Drejtoria e Përgjithshme Gjyqësore dhe e Dokumentacionit njofton kërkuesin me shkrim që brenda 10 ditëve të bëjë plotësimet e nevojshme. Në rast se kërkuesi nuk e paraqet kërkesën/ankimin të plotësuar brenda afatit të caktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Gjyqësore dhe e Dokumentacionit, ajo arkivohet administrativisht. Në rast se kërkesa/ankimi plotësohet brenda afatit, ajo konsiderohet e paraqitur në datën e paraqitjes për herë të parë në Gjykatë.

4. Në rast se kërkesa/ankimi plotëson elementet formale sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, Drejtoria e Përgjithshme Gjyqësore dhe e Dokumentacionit e regjistron atë në Regjistrin Themeltar të Kërkesave për Juridiksionin Disiplinor, si dhe hedh të dhënat e nevojshme në sistemin për menaxhimin e çështjeve.

5. Në Regjistrin Themeltar të Kërkesave për Juridiksionin Disiplinor shënohen, por pa u kufizuar:

a) data e kërkesës/ankimit;

b) objekti i kërkesës/ankimit;

c) të dhënat e kërkuesit/kërkuesve dhe të dhënat e përfaqësuesit ligjor, nëse ka të tillë;

ç) numri i regjistrit, i cili përbëhet nga: numri i kërkesës, iniciali i emrit të kërkuesit, shkurtesa "JD", viti i regjistrimit dhe treguesi "Regjistri Themeltar";

d) gjyqtari relator.

6. Nëse një kërkesë/ankim regjistrohet gabimisht në regjistra të tjerë, me urdhër të Kryetarit bëhet transferimi i regjistrimit në regjistrin përkatës.

7. Drejtoria e Përgjithshme Gjyqësore dhe e Dokumentacionit krijon dosjen përkatëse të kërkesës për procedim disiplinor/ankimit, ku administrohen të gjitha dokumentet shoqëruese të saj.

Neni 7

Caktimi i gjyqtarit relator

1. Për caktimin e gjyqtarit relator zbatohen të njëjtat rregulla procedurale si ato të parashikuara në

nenin 17 të rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

2. Procedura e shortit realizohet duke u bazuar në parimet e transparencës, objektivitetit dhe në shpërndarjen rastësore e të barabartë të ngarkesës së punës midis gjyqtarëve.

3. Në rastin kur kërkesa përmban kërkimin për pezullimin nga detyra, procedura e shortit zhvillohet me përparësi, pa pritur shortin e radhës.

4. Pas caktimit të relatorit të çështjes, Kryetari cakton edhe këshilltarin ligjor, sipas rregullave të përgjithshme të përcaktuara në rregulloren për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 8
Radha e shqyrtimit

Çështjet objekt të kësaj rregulloreje shqyrtohen me përparësi në raport me çështjet e tjera të paraqitura në Gjykatë. Radha e shqyrtimit ndërmjet tyre përcaktohet sipas datës së depozitimit në Gjykatë, duke u dhënë përparësi procedimeve disiplinore dhe kërkesave me natyrë urgjente.

Neni 9
Afati i shqyrtimit paraprak të kërkesave për procedimin disiplinor

1. Shqyrtimi paraprak i kërkesave për procedim disiplinor përfundon sa më shpejt, por në çdo rast brenda dy muajve nga data e regjistrimit të kërkesës.

2. Shqyrtimi paraprak i ankimeve përfundon jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e regjistrimit të ankimit.

3. Shqyrtimi paraprak i kërkesës për pezullimin e subjekteve të parashikuara në pikën 2 të nenit 2 të rregullores përfundon sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 10
Kriteret e pranueshmërisë së kërkesës/ankimit për shqyrtim në seancë plenare

Gjatë shqyrtimit paraprak verifikohen kriteret e pranueshmërisë të parashikuara në nenin 31/a, të ligjit nr. 8577/2000, për aq sa ato janë të zbatueshme për çështjet e juridiksionit disiplinor fillestar dhe rishikues.

Neni 11
Kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare

1. Vendimi për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët e pranishëm në mbledhje dhe përmban: përbërjen e trupës dhe kryesuesin; datën e mbledhjes dhe të dhënat e kërkesës (kërkuesi dhe objekti); bazën ligjore; mënyrën e votimit.

2. Në procesverbalin e votimit përcaktohet:

a) nëse shqyrtimi i çështjes bëhet në seancë plenare publike ose me dyer të mbyllura, sipas parashikimeve të nenit 16 të kësaj rregulloreje;

b) lista e pjesëmarrësve në gjykim.

Neni 12
Njoftimet e palëve në proces

1. Njoftimi për orën dhe datën e zhvillimit të seancës plenare publike bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme Gjyqësore dhe e Dokumentacionit, si rregull, 30 ditë përpara datës së caktuar për zhvillimin e saj, me përjashtim të rasteve kur Gjykata vendos ndryshe.

2. Njoftimi i kërkuesit, subjektit të interesuar ose përfaqësuesit të tyre ose, sipas rastit, i dëshmitarit, ekspertit ose personave të tjerë, pjesëmarrja e të cilëve është e nevojshme për zhvillimin efektiv të gjykimit kushtetues, bëhen sipas përcaktimeve të nenit 5, pika 8, të kësaj rregulloreje.

3. Pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pjesëmarrësve në gjykim u kërkohet adresa e postës elektronike, në rast se nuk e kanë paraqitur më parë atë, me qëllim lehtësimin dhe realizimin e komunikimit deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor, përfshirë njoftimin për shpalljen e vendimit të arsyetuar të Gjykatës.

4. Mosnjoftimi i rregullt shkakton shtyrjen e seancës plenare, si dhe caktimin e një date tjetër për zhvillimin e saj, që njoftohet sipas rregullave përkatëse.

5. Mosparaqitja e kërkuesit ose e palëve të tjera në seancën plenare publike, ose mosparaqitja e parashtrimeve me shkrim, në rastet kur ata janë njoftuar rregullisht nga Gjykata, nuk përbën shkak për moszhvillimin ose shtyrjen e seancës plenare, e cila zhvillohet në mungesë të tyre. Kur seanca zhvillohet mbi bazë të dokumenteve, mosparaqitja brenda afatit të përcaktuar dhe pa shkaqe të

përligjura e parashtrimeve nga kërkuesi ose e parashtrimeve nga subjekti/et i/e interesuara passjell zhvillimin e gjykimit vetëm mbi bazën e kërkesës dhe/ose dokumenteve shoqëruese të saj të paraqitura në momentin e regjistrimit. Gjykata vendos ndryshe në rast se prania ose dëgjimi i palëve në seancë plenare vlerësohet i rëndësishëm për nevoja të gjykimit të çështjes.

6. Kur ndaj subjektit të procedimit disiplinor vendoset pezullimi nga detyra, vendimi i dërgohet menjëherë:

a) subjektit të procedimit disiplinor;

b) Këshillit të Lartë Gjyqësor, kur subjekti është anëtar i tij;

c) Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kur subjekti është anëtar i tij;

ç) Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kur subjekti është Prokurori i Përgjithshëm;

d) Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Kuvendit, kur subjekti është Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

7. Vendimi publikohet menjëherë edhe në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese.

KREU III
PROCEDURAT PËR SEANCËN PLENARE

Neni 13
Veprimet paraprake për shqyrtimin e kërkesës/ankimit

1. Kur kërkesa për procedim disiplinor/ankimi kalon për shqyrtim në seancë plenare, njoftohen palët pjesëmarrëse në gjykim dhe subjekteve të interesuara u dërgohet edhe një kopje e kërkesës/ankimit dhe materialeve bashkëlidhur saj. Palëve u kërkohet të paraqesin parashtrimet e tyre në lidhje me çështjen brenda një afati 30-ditor, përveçse kur Mbledhja e Gjyqtarëve vendos ndryshe, në aq kopje sa janë palët e gjykimit. Nëse vlerësohet nga gjyqtari relator, palëve mund t'u bëhen edhe pyetje specifike, në lidhje me çështjen ose t'u kërkohet çdo dokument tjetër me rëndësi për gjykimin. Gjyqtari relator mund të kërkojë edhe marrjen e informacionit nga subjekte ose organe të tjera që nuk janë palë në proces, duke përcaktuar edhe afatin për këtë qëllim.

2. Njoftimet për seancën plenare dhe komunikimi zyrtar me palët bëhen nga Drejtoria e Përgjithshme Gjyqësore dhe e Dokumentacionit. Gjyqtari relator, nëpërmjet këshilltarit, cakton detyrat dhe ndjek veprimet administrative lidhur me aktet që u vihen në dispozicion gjyqtarëve, kryerjen e njoftimit të palëve, kryqëzimin e parashtrimeve të tyre dhe çdo veprim të nevojshëm për hetimin gjyqësor të çështjes.

3. Pas përfundimit të afatit dhe komunikimit të parashtrimeve përkatëse secilës palë në proces, Kryetari, pasi merr konfirmimin nga gjyqtari relator se çështja është përgatitur në tërësi dhe pasi e diskuton në Mbledhjen e Gjyqtarëve, cakton datën dhe orën e seancës plenare, e cila u komunikohet palëve.

4. Në bazë të formularit tip të akteve që shpërndahen për zhvillimin e seancës plenare, i cili plotësohet dhe verifikohet nga këshilltari i çështjes, Drejtoria e Përgjithshme Gjyqësore dhe e Dokumentacionit përgatit dosjen përkatëse për secilin gjyqtar, ku përfshihen, por pa u kufizuar në to, këto akte:

a) kopje e kërkesës, shpjegimeve dhe akteve të paraqitura nga kërkuesi;

b) prapësimet dhe aktet e paraqitura nga subjektet e interesuara;

c) projektvendimi i gjyqtarit relator, aktet e përgatitura nga këshilltari ligjor sipas udhëzimeve të tij, si dhe çdo akt tjetër që vlerësohet nga gjyqtari relator se ka rëndësi për çështjen.

Neni 14
Të drejtat e pjesëmarrësve në gjykim

1. Pjesëmarrësit në procesin e gjykimit para Gjykatës Kushtetuese kanë këto të drejta:

a) të njihen me dokumentet e dosjes, të marrin ekstrakte ose fotokopje të tyre;

b) të paraqesin prova, si dhe të japin mendim mbi provat e palës kundërshtare;

c) t'i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit, dëshmitarëve, ekspertëve e specialistëve;

ç) të paraqesin kërkesa;

d) të japin shpjegime me shkrim ose me gojë;

dh) të paraqesin përfundimet e tyre;

e) të kundërshtojnë kërkesat e palëve të tjera, përfundimet dhe shpjegimet e tyre, si dhe të paraqesin pretendime përfundimtare.

Neni 15
E drejta për t'u njohur me aktet e dosjes

1. Pjesëmarrësit në gjykim kanë të drejtë të njihen me dokumentet e dosjes dhe të marrin kopje të tyre.

2. Drejtoria e Përgjithshme Gjyqësore dhe e Dokumentacionit, pas paraqitjes së kërkesës për t'u njohur me aktet e dosjes gjyqësore, brenda pesë ditëve nga paraqitja e saj, u siguron pjesëmarrësve në gjykim kushtet për njohjen me dosjen dhe u vë në dispozicion kopje të dokumenteve. Drejtoria cakton një specialist për këtë qëllim dhe i njofton palës së interesuar një orar të përshtatshëm.

3. E drejta për t'u njohur me materialet e dosjes përfshin të drejtën për të kërkuar fotokopje të akteve të dosjes edhe me shënimin "vërtetohet njësia me origjinalin", kundrejt tarifave gjyqësore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Pjesëmarrësve në gjykim, nëse është e mundur, mund t'u jepet kopje edhe në format elektronik.

4. E drejta e aksesit në dosje mund të kufizohet vetëm nëse është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm ndaj interesave të mëposhtëm:

a) të drejtave themelore të një personi tjetër; ose

b) sigurisë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni në fuqi për informacionin e klasifikuar; ose

c) parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale;

ç) barazisë së palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjes së procesit gjyqësor.

5. E drejta e aksesit kufizohet për aq kohë sa ekzistojnë shkaqet e mësipërme, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

6. Pjesëmarrësit në gjykim nuk përfitojnë nga e drejta për t'u njohur me aktet e ndërmjetme, ku përfshihen: aktet ose materialet e përgatitura nga këshilltari ose strukturat e tjera për qëllime të vendimmarrjes; shënimet e relatorit; projektvendimet; procesverbalet e vendimmarrjes dhe të votimit të gjyqtarëve.

7. Për personat e tjerë që nuk janë palë në proces zbatohen rregullat për të drejtën e informimit.

Neni 16
Zhvillimi i seancës plenare

1. Në rastin e juridiksionit disiplinor fillestar, seanca plenare për shqyrtimin e kërkesës për procedim disiplinor, si rregull, është publike dhe zhvillohet sipas të njëjtave rregulla procedurale me ato të përcaktuara në nenet 33–37 të rregullores për procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

2. Përjashtimisht, Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë zhvillimin tërësisht ose pjesërisht të seancës me dyer të mbyllura, vetëm me praninë e palëve, në rastet:

a) kur publiciteti i seancës mund të dëmtojë moralin e shoqërisë ose mund të bëjë publike të dhëna sekrete në interes të sigurisë kombëtare, nëse kjo kërkohet nga autoritetet kompetente;

b) kur është e nevojshme të mbrohet e drejta e jetës private, të mbrohen të dhënat personale të magjistratit ose një personi tjetër;

c) kur nga publiku ka shfaqje që prishin zhvillimin normal të seancës dëgjimore.

3. Në rastin e juridiksionit disiplinor rishikues, seanca plenare për shqyrtimin e ankimit zhvillohet, si rregull, mbi bazë të dokumenteve pa praninë e palëve, në përputhje me rregullat e parashikuara në krerët III–IV të rregullores për procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

4. Palët në gjykim kanë të drejtë të kërkojnë zhvillimin e seancës publike, duke parashtruar arsyet që justifikojnë kërkesën për praninë dhe dëgjimin e tyre. Nëse Gjykata e pranon kërkesën, seanca plenare publike zhvillohet në përputhje me rregullat e nenit 33 të rregullores për Procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

5. Gjykata mund ta refuzojë kërkesën për zhvillimin e seancës publike me vendim të arsyetuar, kur vlerëson se prania ose dëgjimi i palëve në seancë plenare nuk është i nevojshëm për nevoja të gjykimit të çështjes.

KREU IV
PËRGATITJA DHE SHPALLJA E VENDIMIT PËRFUNDIMTAR

Neni 17
Vendimi përfundimtar

1. Rregullat që zbatohen për diskutimin, marrjen, shpalljen, publikimin, saktësimin, plotësimin dhe ndreqjen e vendimit mbi kërkesën/ankimin janë ato të përcaktuara nga nenet 38–43 të rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

2. Kur ndaj subjektit të procedimit disiplinor vendoset shkarkimi nga detyra, përmbledhja e vendimit i dërgohet menjëherë:

a) subjektit të procedimit disiplinor;

b) Këshillit të Lartë Gjyqësor, kur subjekti është anëtar i tij;

c) Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kur subjekti është anëtar i tij;

ç) Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kur subjekti është Prokurori i Përgjithshëm;

d) Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Kuvendit, kur subjekti është Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

3. Vendimi i arsyetuar njoftohet sipas rregullave të përgjithshme të rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

KREU V
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 18
Dispozitë kalimtare

1. Të gjitha veprimet procedurale të kryera nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit përpara përfundimit të mandatit të tij në datën 17.6.2026, në lidhje me dokumentimin, regjistrimin, administrimin ose edhe shqyrtimin paraprak të kërkesave/ankimeve sipas pikave 2 dhe 3, të nenit 2 të kësaj rregulloreje, konsiderohen të vlefshme dhe ruajnë efektet e tyre juridike.

2. Po kështu, konsiderohen të vlefshme dhe ruajnë efektet e tyre juridike edhe veprimet procedurale të kryera nga Gjykata Kushtetuese deri në hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.

3. Kur kërkesa/ankimi ka kaluar fazën e shqyrtimit paraprak nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit përpara datës 17.6.2026, Gjykata vijon shqyrtimin e çështjes sipas fazës procedurale në të cilën ndodhet, sipas rregullave të përcaktuara në këtë rregullore.

4. Afatet e përcaktuara në këtë rregullore zbatohen edhe për çështjet e regjistruara dhe fillojnë të llogariten me hyrjen në fuqi të saj.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 13, datë 2.11.2026

PËR MIRATIMIN E ANEKSIT TË RREGULLORES PËR PROCEDURAT GJYQËSORE TË GJYKATËS KUSHTETUESE, PËR PROCEDURAT GJYQËSORE GJATË SHQYRTIMIT TË ÇËSHTJEVE TË JURIDIKSIONIT TË RIVLERËSIMIT

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar,

në datën 2.11.2026, mori në shqyrtim projektin e aneksit të rregullores për procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese *"Për procedurat gjyqësore gjatë shqyrtimit të çështjeve të juridiksionit të rivlerësimit"*.

Mbledhja e Gjyqtarëve, në mbështetje të nenit 13, shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Miratimin e aneksit të rregullores për procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, "Për procedurat gjyqësore gjatë shqyrtimit të çështjeve të juridiksionit të rivlerësimit", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ky aneks i bashkëlidhet rregullores për procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, miratuar me vendimin nr. 9, datë 22.12.2021, të Mbledhjes së Gjyqtarëve, të ndryshuar dhe është pjesë përbërëse e saj.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese për zbatimin dhe ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 2.11.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji
Anëtarë: Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Marsida Xhaferllari, Asim Vokshi, Marjana Semini
Anëtarë kundër: Sonila Bejtja.

ANEKS I RREGULLORES PËR PROCEDURAT GJYQËSORE TË GJYKATËS KUSHTETUESE

"PËR PROCEDURAT GJYQËSORE GJATË SHQYRTIMIT TË ÇËSHTJEVE TË JURIDIKSIONIT TË RIVLERËSIMIT"

Në mbështetje të neneve 1, pika 2, si dhe 13, shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*), Mbledhja e Gjyqtarëve miraton aneksin me rregullat e procedurave gjyqësore gjatë shqyrtimit të çështjeve të juridiksionit të rivlerësimit, për sa vijon:

Neni 1
Qëllimi

Ky aneks ka për qëllim të sigurojë ushtrimin efektiv të juridiksionit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga Gjykata Kushtetuese, në zbatim të nenit 179/b, pika 8, të Kushtetutës dhe kuadrit ligjor në fuqi, nëpërmjet përcaktimit të rregullave procedurale që garantojnë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si dhe respektimin e të drejtave të pjesëmarrësve në gjykim.

Neni 2
Objekti

1. Objekt i këtij aneksi janë rregullat për shqyrtimin e çështjeve gjatë ushtrimit të juridiksionit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga Gjykata Kushtetuese.

2. Për çështjet procedurale që nuk rregullohen shprehimisht nga ky aneks, gjejnë zbatim ligji nr. 8577/2000 dhe rregullorja për procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, si dhe ligji nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" *(ligji nr. 84/2016),* ky i fundit për aq sa ai është i zbatueshëm.

Neni 3
Regjistrat e posaçëm

1. Për dokumentimin, regjistrimin dhe administrimin e kërkesave, ankimeve dhe vendimeve që lidhen me juridiksionin e rivlerësimit mbahen regjistra të posaçëm, të miratuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve.

2. Në Regjistrin Themeltar të Kërkesave për Juridiksionin e Rivlerësimit shënohen, por pa u kufizuar:

a) data e kërkesës;

b) objekti i kërkesës;

c) të dhënat e kërkuesit/kërkuesve dhe të dhënat e përfaqësuesit ligjor, nëse ka të tillë;

ç) numri i regjistrit, i cili përbëhet nga: numri i kërkesës, iniciali i emrit të kërkuesit, shkurtesa "JV", viti i regjistrimit dhe treguesi "Regjistri Themeltar";

d) gjyqtari relator.

3. Nëse një kërkesë/ankim regjistrohet gabimisht në regjistra të tjerë, me urdhër të Kryetarit bëhet transferimi i regjistrimit në regjistrin përkatës.

Neni 4
Shqyrtimi i kërkesës

1. Në shqyrtimin e çështjeve të juridiksionit të rivlerësimit nga Gjykata Kushtetuese kërkesa shqyrtohet paraprakisht nga Kolegji i përbërë nga tre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ku bën pjesë edhe relatori.

2. Kur kërkesa nuk përmbush kriteret e parashikuara në nenin 31/a, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, kolegji vendos moskalimin e çështjes në seancë plenare. Në të gjitha rastet, kur ndonjë nga gjyqtarët e Kolegjit nuk është i një mendimi me të tjerët, kërkesa i kalon për shqyrtim paraprak Mbledhjes së Gjyqtarëve.

3. Kolegji ose Mbledhja e Gjyqtarëve nuk shqyrton themelin e çështjes në këtë fazë.

4. Vendimi për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare nga Kolegji merret njëzëri, ndërsa nga Mbledhja e Gjyqtarëve merret me shumicën e votave.

5. Gjykata Kushtetuese shqyrton çështjet e juridiksionit të rivlerësimit në seancë plenare me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve, por në asnjë rast të jo më pak se të dy të tretave të tyre.

6. Vendimi merret me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj. Abstenimi nuk lejohet. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët e pranishëm në shqyrtimin e çështjes.

Neni 5
Vëzhguesit ndërkombëtarë dhe roli i tyre

1. Në shqyrtimin e çështjeve të juridiksionit të rivlerësimit, Gjykata Kushtetuese garanton ushtrimin e funksioneve të vëzhguesve ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit *(ONM)*, të cilët mbështesin procesin e rivlerësimit nëpërmjet monitorimit dhe mbikëqyrjes, në përputhje me nenin B, të aneksit të Kushtetutës dhe me natyrën e gjykimit që zhvillon Gjykata Kushtetuese.

2. Vëzhguesit ndërkombëtarë të ONM-së ushtrojnë funksionet dhe të drejtat e tyre gjatë shqyrtimit të çështjeve të rivlerësimit kalimtar nga Gjykata Kushtetuese, në përputhje me parashikimet e Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, për aq sa dispozitat e këtij të fundit janë të zbatueshme në juridiksionin e rivlerësimit nga Gjykata Kushtetuese. Në veçanti ata kanë të drejtë:

a) të kenë akses në dosjen gjyqësore dhe në dokumentacionin që lidhet me çështjen e rivlerësimit, në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi. Aksesi përfshin njohjen me aktet e dosjes, provat, dokumentet e administruara dhe materialet e tjera që kanë rëndësi për ushtrimin e funksioneve të monitorimit. Aksesi në dokumentet që përmbajnë informacion të klasifikuar, të dhëna personale ose informacione të tjera të mbrojtura nga ligji realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke respektuar njëkohësisht detyrat kushtetuese të vëzhguesve ndërkombëtarë;

b) të paraqesin gjetje mbi çështje të rivlerësimit kalimtar që shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese, duke përfshirë mendime me shkrim për rrethana konkrete ose për fakte që rezultojnë gjatë shqyrtimit të çështjes. Këto mendime mund të merren në konsideratë nga Gjykata gjatë vendimmarrjes, por nuk kanë vlerën e provës. Lidhur me gjetjet, vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojë që Gjykata të marrë në shqyrtim prova ose të paraqesë prova të marra nga organet shtetërore, entitetet e huaja ose personat privatë, sipas ligjit;

c) të jenë të pranishëm gjatë të gjitha fazave të shqyrtimit të çështjes, përfshirë dhomën e këshillimit dhe marrjen e vendimit. Në çdo rast, prania e vëzhguesve ka karakter monitorues dhe nuk përfshin të drejtën e votës ose pjesëmarrjen në vendimmarrje.

3. Gjykata Kushtetuese merr masa për njoftimin e vëzhguesve ndërkombëtarë për kalendarin e seancave gjyqësore dhe mbi veprimet procedurale që lidhen me shqyrtimin e çështjeve të juridiksionit të rivlerësimit, me qëllim garantimin e ushtrimit të funksioneve të tyre. Për këtë qëllim, dokumentacioni u vihet në dispozicion në kohë të përshtatshme për ushtrimin efektiv të funksioneve të tyre, në formë elektronike, në adresat elektronike të dakordësuara ose shkresore, sipas rastit.

Neni 6
Përkthimi dhe interpretimi gjuhësor

1. Përkthimi i akteve dhe i dokumenteve të reja të dosjes gjyqësore, si dhe interpretimi gjatë seancave plenare dhe veprimeve të tjera procedurale ku marrin pjesë vëzhguesit ndërkombëtarë, organizohet dhe mbulohet nga Gjykata Kushtetuese në koordinim me ONM-në.

2. Gjykata Kushtetuese bashkëpunon me ONM-në për vënien në dispozicion, në kohën e duhur, të dokumentacionit dhe të informacionit të nevojshëm për realizimin e përkthimit dhe interpretimit gjuhësor.

Neni 7
Dispozitë kalimtare

1. Të gjitha veprimet procedurale të kryera nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit përpara përfundimit të mandatit të tij në datën 17.6.2026, në lidhje me dokumentimin, regjistrimin, administrimin ose edhe shqyrtimin paraprak të kërkesave që lidhen me juridiksionin e rivlerësimit, ende të papërfunduara, konsiderohen të vlefshme dhe ruajnë efektet e tyre juridike. Ky efekt shtrihet edhe për të gjitha përkthimet e kryera nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit.

2. Po kështu, konsiderohen të vlefshme dhe ruajnë efektet e tyre juridike edhe veprimet

procedurale të kryera nga Gjykata Kushtetuese deri në hyrjen në fuqi të këtij aneksi.

3. Kur kërkesa ka kaluar fazën e shqyrtimit paraprak nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit përpara datës 17.6.2026, Gjykata vijon shqyrtimin e çështjes sipas fazës procedurale në të cilën ndodhet, sipas rregullave të përcaktuara në këtë rregullore.

4. Afatet e përcaktuara në këtë aneks zbatohen edhe për çështjet e regjistruara dhe fillojnë të llogariten me hyrjen në fuqi të saj.

Neni 8
Hyrja në fuqi

1. Ky aneks i bashkëngjitet rregullores për procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, e miratuar me vendimin nr. 9, datë 22.12.2021, të Mbledhjes së Gjyqtarëve, e ndryshuar dhe është pjesë përbërëse e saj.

2. Aneksi hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 87, datë 1.10.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahimi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 1.10.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 52 (A) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Aurel Koçibelli, Renato Koçibelli, Servet Fekaj dhe Sezai Shehu, përfaqësuar nga avokati Kristiano Koçibelli, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm, Elsonida Rama.

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm, Llambriola Misto.

Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga avokatja e shtetit Denisa Skënderaj.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 2205, datë 17.12.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2025-2077, datë 27.5.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, pika 2, 17, 18, 44, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1 dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesve Aurel Koçibelli, Renato Koçibelli, Servet Fekaj dhe Sezai Shehu (*kërkuesit*), që kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Këshilli i Ministrave, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit (*MTKS*) dhe Avokatura e Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë bashkëpronarë të një sipërfaqeje trualli prej 407 m^2, sipas kufizimeve përkatëse, që ndodhet në qytetin e Korçës, në të cilin ka qenë ndërtuar "Muzeu i Rilindjes Kombëtare", i cili është rrënuar për shkaqe natyrore. Në këtë ndërtesë në datën 16.12.1916, është ngritur flamuri kombëtar. Me vendimin e datës 5.11.1993, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Bashkisë së Korçës ia ka kthyer pasurinë subjekteve të shpronësuara, të cilët, në datën 30.3.2001, ua kanë shitur atë kërkuesve Servet Fekaj, Sezai Shehu dhe trashëgimlënësit të kërkuesve të tjerë B. K. (*bashkëpronarët*).

2. Në datën 30.5.2014, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve ka miratuar zbatimin e projektit "Rindërtimi i banesës ku u ngrit Flamuri në Korçë",

me vlerë 33.748.898 lekë pa TVSH dhe 40.498.680 lekë me TVSH. Në datën 18.2.2016, pranë Ministrisë së Kulturës (sot MTKS-ja) është paraqitur kërkesa për shpronësim publik të pasurisë së paluajtshme që preket nga zbatimi i projektit dhe për këtë qëllim, me urdhrin e datës 23.2.2016, është ngritur Komisioni i Posaçëm për Ndjekjen e Procedurave të Shpronësimit (*Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit*), i cili ka vendosur shpronësimin e pasurisë duke e llogaritur me vlerën 8.537 lekë/m^2.

3. Pas njoftimit të vendimit për shpronësim, bashkëpronarët kanë paraqitur kërkesë për marrjen përsipër të realizimit të projektit, e cila është rrëzuar nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, me argumentin se qëllimi i tyre nuk përputhet me atë të MTKS-së, pasi ka një karakter biznesi, i cili bie ndesh me synimin për të pasur një muze me vlerë të shtuar të trashëgimisë kulturore të Korçës dhe një aset turistik. Në datën 4.3.2016, është dërguar për publikim në Fletoren Zyrtare shpallja e kërkesës për shpronësim publik.

4. Në vijim, bashkëpronarët kanë paraqitur kundërshtitë e tyre së bashku me dokumentacionin shoqërues. Në përgjigje Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, në datën 31.3.2016, i ka njoftuar ata se procedura e shpronësimit do të vazhdojë, pasi qëllimi i angazhimit të bashkëpronarëve nuk përputhet me qëllimin e shpronësimit.

5. Në përfundim të procedurave, Këshilli i Ministrave, me vendim nr. 347, datë 4.5.2016, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga zbatimi i projektit "Rindërtimi i banesës ku u ngrit flamuri në Korçë"" (*Vendimi i Shpronësimit*), ka vendosur shpronësimin për interes publik, për bashkëpronarët në masën 2.316.373 lekë (përkatësisht B. K. dhe Servet Fekaj në masën 579.093 lekë secili dhe Sezai Shehu në masën 1.158.187 lekë). Procedura dhe vlera e shpronësimit janë kundërshtuar nga bashkëpronarët në gjykatë.

6. Gjatë gjykimit, gjykata ka caktuar një ekspert me detyrë përllogaritjen e vlerës reale të pronës dhe truallit në bashkëpronësi referuar kuadrit ligjor të vlerësimit të pasurive të paluajtshme për efekt shpronësimi. Sipas aktit të ekspertit, prona ndodhet në zonën qendrore të qytetit të Korçës me ndërtesa muzeale, tërheqëse për tregun, me dalje direkt në rrugë dhe ku mbizotërojnë ambientet e shërbimit dhe tregtimit. Trualli në zonën ku ndodhet prona vlerësohet me vlerën 42.000 lekë/m^2, kjo referuar studimit të tregut dhe mbledhjes së informacionit nga kontratat e shitjeve. Eksperti e ka përcaktuar vlerën e pronës me metodën e zhvillimit, duke nxjerrë vlerën e një ndërtese që mund të ngrihet mbi truallin me sipërfaqe 407 m^2, së cilës i ka zbritur vlerën e shpallur në tender për rindërtimin e godinës dhe me metodën e kostos duke i shtuar vlerës së shpallur në tender atë të truallit.

7. Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin nr. 366 (155), datë 7.3.2017, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se Vendimi i Shpronësimit nuk ka cenuar të drejtat e pronarit, në kushtet kur ka mospërputhje të interesit të tij me interesin publik, ndërsa për sa i takon masës së shpronësimit, çmimi i referohet hartës së vlerës në përputhje me kriteret ligjore. Sipas saj, në momentin e fillimit të procedurave të shpronësimit dhe hartimit të raportit të vlerësimit nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, vlerësimi i truallit është bërë në bazë të vendimit nr. 89, datë 2.3.2016, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e vlerës së pronës në secilin qark të Republikës së Shqipërisë" *(Vendimi për Vlerën e Pronës*). Ky vendim ka dalë në bazë të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, si dhe pikës 3 të vendimit nr. 658, datë 26.9.2012, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë" (*Vendimi për Metodologjinë e Pronës*), që përbën burimin e vetëm zyrtar për përllogaritjen e vlerës së pasurisë së paluajtshme. Për zonën ku ndodhet sipërfaqja e truallit objekt gjykimi, vlera e truallit është 8.537 lekë/m^2. Ndërsa vlerat e referuara nga eksperti nuk janë nxjerrë në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor të vlerësimit të pasurive të paluajtshme për efekt shpronësimi dhe nuk mbështeten as në të dhëna zyrtare të tregut të shitjes së trojeve në zonën ku ndodhet trualli objekt gjykimi. Përveç kësaj, ka argumentuar gjykata, eksperti ka përcaktuar vlerën e pronës me metodën e zhvillimit dhe me metodën e kostos, por në rastin e shpronësimit ligji i referohet një prone ekzistuese që mund të jetë e llojit "truall", "tokë bujqësore" ose "ndërtesë më qëllim të caktuar përdorimi" dhe vlerësimi bëhet për pronën me parametrat e të dhënat identifikuese që ajo ka në momentin e shpronësimit, pasi të dhënat e saj përbëjnë dhe bazën e vlerësimit në kuptim të ligjit (destinacioni, vendndodhja, etj.). Si metoda e

zhvillimit, ashtu edhe ajo e kostos nuk mund të gjejnë zbatim, pasi objekt shpronësimi është një sipërfaqe trualli dhe jo objekt ndërtimor. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim bashkëpronarët. Gjatë kohës që çështja po gjykohej në shkallë të dytë, njëri nga bashkëpronarët B. K. ka ndërruar jetë dhe në gjykim janë thirrur trashëgimtarët ligjorë të tij.

8. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2205, datë 17.12.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, mbi të njëjtën linjë arsyetimi, duke argumentuar se nuk rezulton që bashkëpronarët paraprakisht, pra, pa u vënë në dijeni të nisjes së shpronësimit, të kenë kërkuar leje nga organet kompetente për realizimin e interesit publik. Sipas saj, në kushtet kur çmimi i shpronësimit referohet në hartën e vlerës të krijuar në përputhje me kriteret ligjore, gjykata nuk mund të dalë tej kritereve të dispozitave ligjore në fuqi dhe vlera e truallit që duhet të shpërblehet për efekt shpronësimi rezulton e llogaritur në përputhje me vendimin e vitit 2016. Po kështu, ka argumentuar gjykata administrative e apelit, "harta e vlerës" nuk është gjë tjetër veçse rezultati i përpunimit të të dhënave të shitjeve të pasurive të evidentuara nga zyrat e regjistrimit, kriter që gjen rregullim të shprehur në vendimin nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave *"Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik",* i ndryshuar (*Vendimi për Kriteret Teknike të Vlerësimit*) dhe Vendimin për Metodologjinë e Pronës, sipas të cilave harta e vlerës krijohet pas përpunimit të të dhënave të grupuara nga kontratat e shitjes të regjistruara për një periudhë 1-vjeçare për të gjitha llojet e pasurive të paluajtshme sipas zonave kadastrale të çdo qarku. Në kushtet kur çmimi i shpronësimit referohet në hartën e vlerës së krijuar në përputhje me kriteret e ligjit, padia duhet të rrëzohet. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs kërkuesit.

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-2077, datë 27.5.2025, ka vendosur, në dhomën e këshillimit, mospranimin e rekursit, me argumentin se nuk ka ngritur asnjë shkak ligjor të parashikuar nga neni 58, i ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*Ligji për Gjykatat Administrative*). Sipas Gjykatës së Lartë, është detyrë e palës rekursuese të parashtrojë qartësisht dhe në mënyrë të plotë në rekurs shkaqet ligjore, duke argumentuar se përse është zbatuar në mënyrë të gabuar nga gjykata ligji material ose procedural dhe përse shkalla e shkeljes është e një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, si dhe cilat janë ato shkelje të rënda procedurale që ndikojnë dukshëm në dhënien e vendimit. Po sipas saj, nëse shkaqet ligjore nuk arrihen të parashtrohen dhe të argumentohen sipas kërkesave ligjore, atëherë Gjykata e Lartë është e detyruar të vendosë mospranimin e rekursit.

10. Në datën 30.10.2025, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit, është regjistruar në datën 6.11.2025. Me vendimin e datës 23.1.2026, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. Kërkuesit, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u janë cenuar:

11.1 *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

11.1.1 *Së drejtës së aksesit në aspektin substancial*, pasi gjykata e apelit dhe në veçanti Gjykata e Lartë nuk u kanë dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të tyre, kryesisht atyre të lidhura me masën e shpërblimit nga shpronësimi.

11.1.2 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i gjykatës së apelit është qartazi i paarsyetuar dhe ka kopjuar arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë. Po kështu, edhe Gjykata e Lartë nuk ka bërë asnjë lloj parashtrimi lidhur me pretendimet e tyre dhe nuk ka dhënë asnjë shpjegim për shkaqet e rekursit.

11.2 *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41, pika 4, i Kushtetutës, pasi gjykatat nuk kanë garantuar shpronësimin përkundrejt një shpërblimi të drejtë. Analizimi i vlerësimit për shpërblim të drejtë është trajtuar nga Gjykata e Lartë në praktika të mëparshme gjyqësore të njëjta ose të ngjashme, të shqyrtuara edhe nga e njëjta trupë gjyqësore.

12. *Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit*, në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar me të njëjtat argumente se:

12.1 Pretendimi për cenimin *e së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar, pasi:

12.1.1 *E drejta e aksesit në aspektin substancial* është respektuar, sepse kërkuesit kanë ushtruar të drejtën e tyre të paraqitjes së padisë/ankimit/rekursit, ku përmes një procesi gjyqësor që ka analizuar themelin e çështjes, me vendim përfundimtar kanë marrë përgjigje të arsyetuar për të gjitha pretendimet, në veçanti për masën e shpërblimit të drejtë që u takonte sipas ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete.

12.1.2 Gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje të arsyetuar të gjitha pretendimeve të kërkuesve, ndërsa Gjykata e Lartë ka vepruar brenda kompetencës së saj dhe interpretimi i ligjit nuk është arbitrar, ndaj mënyra e *arsyetimit* përmbush standardet kushtetuese. Në thelb, parashtrimet nuk janë me natyrë kushtetuese, por kanë të bëjnë me mënyrën e shqyrtimit e vlerësimit të provave, si dhe interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme.

12.2 Pretendimi për cenimin *e së drejtës së pronës* i lidhur me të drejtën për shpërblim të drejtë nuk qëndron, pasi procesi gjyqësor i zhvilluar ka qenë i rregullt dhe argumentet e kërkuesve nuk reflektojnë asnjë shkelje kushtetuese.

13. *Subjekti i interesuar, MTKS-ja*, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

13.1 Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* nuk qëndron, sepse:

13.1.1 Vendimi i mospranimit të rekursit nga Gjykata e Lartë nuk përbën refuzim arbitrar *të aksesit në gjykatë*, por një kufizim procedural të ligjshëm, proporcional dhe të justifikuar nga funksioni i saj subsidiar si gjykatë ligji, si dhe një aplikim të drejtpërdrejtë dhe të parashikueshëm të filtrit ligjor, ndaj aksesi në gjykatë ka respektuar garancitë e kërkuara. Gjykata e Lartë e ka ushtuar kompetencën e saj si gjykatë ligji.

13.1.2 Në kushtet kur rekursi nuk përmbush kriteret e qarta dhe të parashikueshme ligjore, Gjykata e Lartë nuk ka asnjë detyrim të zhvillojë analizë të zgjeruar të pretendimeve të tij. Vendimi i dhënë është në përputhje të plotë me praktikën e konsoliduar të vet Gjykatës së Lartë dhe përmbush *standardet e arsyetimit*.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

14. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret e pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund t'i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Duke pasur parasysh natyrën kumulative të kritereve të pranueshmërisë dhe jurisprudencën e saj, Gjykata vëren se kriteret *ratione personae*, *shterimi i mjeteve juridike efektive* dhe *ratione temporis* janë të përmbushura. Në lidhje me to nuk rezulton të ketë çështje që kërkojnë analizë të mëtejshme, ndërsa as subjektet e interesuara nuk kanë ngritur ndonjë prapësim.

16. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesit kanë pretenduar se u është cenuar e *drejta për proces të rregullt ligjor* (në drejtim të së drejtës së aksesit substancial dhe standardit të arsyetimit të vendimit) dhe e *drejta e pronës private* e lidhur me *të drejtën për shpërblim të drejtë*, të garantuara respektivisht nga nenet 42 dhe 41 të Kushtetutës. Argumentet e parashtruara në mbështetje të këtyre pretendimeve, në thelb, kanë të bëjnë me shpronësimin përkundrejt një shpërblimi të drejtë. Ndërsa subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se pretendimet e kërkuesve kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit dhe me çmuarjen e provave, ndaj nuk përbëjnë çështje kushtetuese.

17. Neni 41 i Kushtetutës, teksa garanton të drejtën e pronës private (*pika 1*), përcakton, ndër të tjera, se ligji mund të parashikojë shpronësimin vetëm për interesa publikë (*pika 3),* ndërsa shpronësimi lejohet vetëm përkundrejt një

shpërblimi të drejtë (*pika 4)* dhe për mosmarrëveshjet për masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë (*pika 5*).

18. Në jurisprudencën kushtetuese, për sa u takon garancive të nenit 41 të Kushtetutës, është pohuar se e drejta e pronës përjashtimisht mund të cenohet vetëm në formën e *"shpronësimit"* dhe të *"kufizimit"*. Kufizimi i ligjshëm që mund t'i bëhet së drejtës së pronësisë, në njërën prej këtyre dy situatave, kërkohet të realizohet me *"ligj", "vetëm për interesa publikë"* dhe *"vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë"* (*shih vendimin nr. 17, datë 23.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Shpërblimi i drejtë është koncept kushtetues i lidhur me rastet e shpronësimit ose kufizimit të së drejtës së pronës me ligj për interesa publikë gjatë një marrëdhënieje midis individit pronar dhe shtetit, ku individi zhvishet nga e drejta e pronësisë sa herë që ndërhyn një interes publik dhe ka të drejtë të ketë pretendime vetëm për masën e shpërblimit (*shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata ka vënë në dukje se në rastet e shpronësimit për interes publik është fakt i pakundërshtueshëm se pronarët e pronës që shpronësohet pësojnë ndërhyrje me ligj në të drejtën themelore të pronës, ndërhyrje e cila plotëson edhe kriterin e interesit publik dhe se çështja kryesore që shtrohet për zgjidhje përpara gjykatave të zakonshme, në këto raste, lidhet me proporcionalitetin e ndërhyrjes, konkretisht me vlerën e shpërblimit për shpronësimin. Sipas Gjykatës, edhe pse gjykatat e zakonshme, si rregull, janë në pozicionin më të mirë për të përcaktuar ekzistencën dhe masën e dëmit, për shkak të kompetencës së tyre për të shqyrtuar dhe vlerësuar provat, ajo, sipas neneve 41, pika 4 dhe 17, të Kushtetutës, ka juridiksion për të vlerësuar nëse shpërblimi për shpronësimin është i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm, pra nëse është proporcional dhe nëse individit i është vendosur një barrë individuale e tepruar (*shih vendimin nr. 82, datë 18.12.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se kontrolli kushtetues përfshin edhe verifikimin e efektivitetit të mbrojtjes gjyqësore për garantimin e së drejtës për shpërblim të drejtë, pa zëvendësuar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në përcaktimin e masës konkrete të tij. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se prapësimi i subjekteve të interesuara se pretendimet e kërkuesve nuk përbëjnë çështje kushtetuese nuk qëndron, ndaj, në themel, do t'i shqyrtojë bashkërisht pretendimet për aksesin substancial në gjykatë dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhura me garancinë e shpërblimit të drejtë dhe proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e pronës. Ndërsa argumentet për qëndrimet e ndryshme të kolegjit të Gjykatës së Lartë do të merren në konsideratë për aq sa kanë rëndësi për vlerësimin e standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore të kundërshtuara.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial në gjykatë dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhura me garancinë e shpërblimit të drejtë dhe proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e pronës

21. Kërkuesit kanë parashtruar se vendimi i gjykatës së apelit është qartazi i paarsyetuar dhe ka kopjuar arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë. Po ashtu, edhe Gjykata e Lartë nuk ka bërë asnjë lloj parashtrimi lidhur me pretendimet e tyre të paraqitura në rekurs, por thjesht ka cituar nenin 58 të Ligjit për Gjykatat Administrative. Sipas kërkuesve, gjykata e apelit dhe në veçanti Gjykata e Lartë nuk u kanë dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të tyre të lidhura me masën e shpërblimit nga shpronësimi, por janë mjaftuar me vlerën e Vendimit të Shpronësimit, duke marrë *a priori* vlerën referuese të hartës së vlerës të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Lidhur me sa më sipër, Gjykata e Lartë ka praktika të mëparshme gjyqësore të njëjta ose të ngjashme, të shqyrtuara edhe nga e njëjta trupë gjyqësore, që kanë analizuar shpërblimin e drejtë në raste të shpronësimit për interes publik.

22. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave, MTKS-ja dhe Avokatura e Shtetit, kanë prapësuar se procesi gjyqësor i zhvilluar ka qenë i rregullt dhe argumentet e kërkuesve nuk reflektojnë asnjë shkelje kushtetuese. Kërkuesit kanë ushtruar të drejtën e tyre të paraqitjes së padisë/ankimit/rekursit, ku përmes një procesi gjyqësor që ka analizuar themelin e çështjes, me vendim përfundimtar kanë marrë përgjigje të arsyetuar për të gjitha pretendimet e tyre dhe në veçanti për masën e shpërblimit të drejtë që u takonte sipas ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete. Sipas tyre, gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje të arsyetuar të gjitha pretendimeve të kërkuesve dhe mënyra e arsyetimit të saj përmbush të gjitha kriteret kushtetuese. Ndërkohë, Gjykata e Lartë ka vepruar brenda

kompetencës së saj dhe interpretimi i ligjit nuk është arbitrar.

23. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit në gjykatë nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 30, datë 2.5.2025; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 56, datë 25.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Po kështu, Gjykata ka pohuar se standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e së drejtës së aksesit në gjykim dhe funksioni i vendimit të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.3.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi i kufizuar i vendimeve të mospranimit të rekursit, si rregull, nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to *(shih vendimet nr. 79, datë 30.6.2026; nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese).*

25. Gjykata ka vënë në dukje se shpronësimi është një institut juridik, i cili, nëpërmjet një akti individual të bazuar në ligj dhe për interes publik, shuan të drejtën e pronës për një pasuri private, në këmbim të një shpërblimi të drejtë, në rastet kur kjo është e nevojshme për të realizuar përmbushjen e interesit publik. Shpronësimi është rezultat i masave ose i reformave të planifikuara për të përmbushur interesa publikë, ndaj ligjvënësi dhe ekzekutivi, si rregull, gëzojnë hapësirë të gjerë vlerësimi në caktimin e shpërblimit, sepse janë në pozicionin e duhur për të pasur njohuri të drejtpërdrejta të shoqërisë, nevojave dhe burimeve. Në këtë drejtim, një kusht thelbësor është vlerësimi nëse përdorimi i ri i pasurisë që shpronësohet do të sjellë dobi publike më të madhe sesa ajo që rrjedh nga përdorimi aktual i saj, pra kur interesi publik mbizotëron kundrejt interesave privatë të pronarit të pasurisë (*shih vendimin nr. 82, datë 18.12.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Po sipas Gjykatës, natyra e shpërblimit nga shpronësimi ndryshon nga ajo e dëmshpërblimit sipas së drejtës civile, pasi nuk synon të rimbursojë individin e prekur nga të gjitha humbjet aktuale dhe të ardhshme që lidhen me dëmin e pësuar, siç është fitimi i munguar. Qëllimi i shpërblimit sipas nenit 41, pika 4, të Kushtetutës, është të rivendosë një gjendje "të barasvlershme me gjendjen e mëparshme" (*shih vendimin nr. 82, datë 18.12.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Thelbi i garancisë kushtetuese, të parashikuar në nenin 41, pika 4, të Kushtetutës, është të garantojë ekuilibrin midis interesit publik dhe shuarjes të së drejtës së pronës së individit, prej nga rrjedh detyrimi i prerë dhe i pakushtëzuar i shtetit për të siguruar një shpërblim të drejtë për shpronësimin. Ky shpërblim mund të korrespondojë me një vlerësim të plotë, por mund të jetë edhe më i ulët, pasi llogaritja e tij nuk merr në konsideratë vetëm interesin e individit të prekur, por e peshon atë në raport me interesin publik. Megjithatë, shpërblimi dukshëm i ulët vendos barrë joproporcionale ndaj individit dhe mund të përbëjë cenim të Kushtetutës. Për këtë arsye, autoritetet kompetente, gjatë procedurës së shpronësimit, dhe më tej gjykatat e zakonshme, gjatë procesit gjyqësor, duhet të shqyrtojnë me kujdes të gjithë faktorët relevantë për përcaktimin e shpërblimit nga shpronësimi për të arritur ekuilibrin e duhur dhe për të mos i vendosur individit një barrë të tepruar. Shpërblimi nga shpronësimi duhet të jetë domosdoshmërish rezultat i ekuilibrimit të interesave të individit të shpronësuar me ato të publikut të gjerë. Ai nuk mund të përfaqësojë as njohjen e njëanshme të interesave të pronarit dhe as vetëm ato të publikut të gjerë (*shih vendimin nr. 82, datë 18.12.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në vështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata vëren se kërkuesit kundërshtojnë vendimin e gjykatës së apelit që ka lënë në fuqi vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë dhe atë të Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur mospranimi i rekursit të tyre. Në situatën kur rekursi nuk është shqyrtuar në themel dhe për të respektuar kufirin midis juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor, Gjykata për zgjidhjen e çështjes do të verifikojë nëse pretendimet e ngritura në rekurs kishin natyrë kushtetuese dhe nëse Gjykata e Lartë u ka dhënë

pretendimeve përgjigje të arsyetuar, në përputhje me garancitë e aksesit substancial në gjykatë dhe të arsyetimit të vendimit gjyqësor, në funksion të mbrojtjes të së drejtës për shpërblim të drejtë.

29. Gjykata fillimisht vëren se prona e kërkuesve është shpronësuar për shkak se godina e rrënuar do të rindërtohej për t'u kthyer në muze për ta shndërruar atë në një aset turistik, me synim shtimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit të Korçës. Për këtë qëllim është miratuar edhe projekti për rindërtimin e saj me vlerë 33.748.898 lekë pa TVSH dhe 40.498.680 lekë me TVSH, ndërsa kërkuesit kanë marrë shpërblim në masën 2.316.373 lekë, kurse sipas ekspertit të caktuar nga gjykata pasuria e kërkuesve vlerësohej në masën përfundimtare 55.500.000 lekë. Për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet e paarsyeshme që kërkuesit kishin pritshmëri për një vlerë më të lartë shpërblimi.

30. Po kështu, Gjykata konstaton se gjykata administrative e shkallës së parë ka caktuar ekspert gjatë gjykimit, i cili ka evidentuar se prona ndodhet në qendrën e qytetit, ka një pozicion shumë të mirë me bulevardin kryesor të qytetit dhe është e vendosur në një zonë tërheqëse për tregun, gjë e cila e rrit shumë vlerën e saj. Eksperti ka analizuar se nga studimi i vlerave të tregut të pronave në zonën ku ndodhet trualli rezulton se janë realizuar shitje pronash me destinacion ndërtime për banim dhe tregtim, ku çmimi i njësive varion nga 300.000–350.000 lekë/m^2 dhe nëse mbi këtë sipërfaqe trualli ndërtohet një ndërtesë me sipërfaqe ndërtimore 240 m^2 dhe 3 kate, do të kishte një zhvillim me vlerë totale 194.400.000 lekë. Ndërsa, nëse do të ndërtohet një ndërtesë siç ka qenë dhe do të përdoret si ambient banimi, vlera totale llogaritet në 75.320.000 lekë. Mirëpo, sipas ekspertit, ndërtimi për pronën në fjalë është i kufizuar dhe pasuria do të ketë një zhvillim të kufizuar, pasi do të përdoret si shtëpi-muze, pra nuk do të përdoret as si njësi, as si ambient banimi. Për pasuri të këtij lloji nuk ka prova të krahasueshme dhe vlerësimi i pronës bëhet me metodën e kostos dhe në kushtet kur nuk ka as ndërtesë ekzistuese në të do të përdoret metoda e zhvillimit, bazuar në konceptin se toka vlen për atë që mund të ndërtohet ose rindërtohet mbi të. Po sipas ekspertit, metoda e kostos përdoret për prona të veçanta që ndërtohen dhe përdoren për qëllime të veçanta, si shkolla, qendra specializimi, muze, stadiume, aeroporte, kisha, spitale etj. Për të nxjerrë vlerën e një prone të tillë duhet të hartohet projekti që do të zhvillohet, nga ku llogaritet edhe preventivi përkatës. Për pronën objekt gjykimi është bërë një projekt për t'u zbatuar (tenderi) me vlerë 33.748.898 lekë pa TVSH dhe 40.498.680 lekë me TVSH, duke i shtuar edhe vlerën e truallit 17.000.000 lekë (407 m^2 x 42.000 lekë/m^2), pra vlera me metodën e kostos përllogaritet në masën 57.498.680 lekë. Po sipas ekspertit, vlerësimi i truallit sipas vlerave të tregut përllogaritet në masën 42.000 lekë/m^2, ndërsa masa 8.537 lekë/m^2 është një vlerë reference. Në vijim, sipas përllogaritjeve të ekspertit, nga vlera totale e zhvillimit të truallit prej 194.400.000 lekësh, duke zbritur koston e ndërtimit 33.750.000 lekë (që përfaqëson vlerën e tenderit për ndërtimin e objektit), vlera e pronës do të ishte 53.550.000 lekë (160.650.000 lekë x 30%). Në përfundim, eksperti ka nxjerrë vlerën e pronës në masën 55.500.000 lekë.

31. Ndërkohë, kjo provë nuk u vlerësua e besueshme nga gjykata e shkallës së parë, e cila ka referuar vlerën e nxjerrë nga aktet nënligjore, masa e së cilës dukshëm është më e ulët se ajo e tregut e përdorur nga eksperti (nga 8.537 lekë/m^2 në 42.000 lekë/m^2). Kërkuesit e kanë kundërshtuar arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë në ankim, duke kërkuar që vlera e shpronësimit të mos jetë ajo sipas vendimit të vitit 2016, por sipas vlerës së tregut të lirë të pronave në masën 57.498.680 lekë. Përkundër këtij kërkimi, gjykata e apelit, ndonëse ka argumentuar se metoda e zhvillimit dhe ajo e kostos nuk mund të gjejnë zbatim në rastin konkret, pasi objekt shpronësimi është një sipërfaqe trualli dhe jo objekt ndërtimor, nuk ka arsyetuar nëse, në parim, pretendimi për shpërblimin sipas vlerës së plotë të pronës është i bazuar dhe, mbi këtë bazë, në pasojë të saj, nuk ka hetuar në lidhje me këtë vlerë. Papranueshmëria e vlerës së pronës të llogaritur sipas një metode të caktuar nuk e bën të papranueshëm, në thelb, pretendimin se vlera e shpronësimit në rastin konkret nuk përmbush garancinë kushtetuese të shpërblimit të drejtë. Për më tepër, referuar akteve nënligjore, në mungesë të të dhënave për çmimet e tregut për zonën përkatëse për ndërtime të këtij lloji, sikurse shtëpi-muze, vlera e shpronësimit përcaktohet përmes metodës së krahasimit të drejtpërdrejtë me atë të zonës përreth.

32. Në vazhdim, kërkuesit kanë paraqitur rekurs, ku kanë parashtruar në mënyrë të qartë mosrespektimin e ligjit me pasojë cenimin e së drejtës për shpërblim të drejtë dhe mosrespektimin e praktikës gjyqësore të vet Gjykatës së Lartë, duke

cituar gjashtë vendime të saj (*vendimet nr. 00-2024-2906 (301), datë 4.7.2024; nr. 00-2023-2208 (194), datë 1.6.2023; nr. 00-2023-1663 (145), datë 2.5.2023; nr. 00-2023-371 (57), datë 14.2.2023; nr. 00-2022-3298, datë 24.11.2022; nr. 00-2022-928 (225), datë 2.6.2022, të Gjykatës së Lartë të pasqyruara në faqet 12–13 të rekursit*). Sipas kërkuesve, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrimin se shpërblimi i drejtë nuk është çmimi i vendosur nga organi publik sipas vendimeve përkatëse, por ai çmim që u përgjigjet sa më mirë interesave të paditësit dhe që është një masë shpërblimi proporcionale dhe e kënaqshme për standardet ekonomike dhe sociale të paditësit. Po kështu, kërkuesit kanë pretenduar mungesë arsyetimi nga gjykata e apelit për pretendimet e parashtruara në ankim. Pavarësisht kësaj, Gjykata e Lartë nuk i ka marrë në shqyrtim ato, duke u shprehur se është detyrë e palës rekursuese të parashtrojë qartësisht dhe në mënyrë të plotë në rekurs shkaqet ligjore. Pra, megjithëse rekursi kishte të bënte me një shkelje potenciale të të drejtave kushtetuese, të cilën gjykatat e zakonshme kanë detyrimin ta shqyrtojnë me kujdesin e duhur, Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e tij, pa u dhënë përgjigje të shprehur kërkuesve.

33. Në analizë të sa më sipër, Gjykata çmon se kërkuesit nuk kanë marrë përgjigje të arsyetuar për pretendimet e tyre, të cilat, në thelb, vinin në diskutim efektivitetin e mbrojtjes gjyqësore të së drejtës për shpërblim të drejtë, në kuptim të neneve 41, pikat 4 dhe 5, 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Për këtë arsye, ata kërkonin përgjigje nga Gjykata e Lartë, në ushtrim të juridiksionit të saj rishikues, e cila i ka trajtuar pretendimet e tyre në mënyrë të përgjithshme, duke i kaluar në këtë mënyrë barrën e provës kërkuesve pa dhënë arsye se përse pretendimet për zbatimin e kritereve ligjore të shpërblimit dhe për mjaftueshmërinë e mbrojtjes gjyqësore të kësaj të drejte nuk kërkonin shqyrtim në kuadër të shkaqeve ligjore të rekursit. Mangësia e konstatuar qëndron në mungesën e përgjigjes ndaj përmbajtjes ligjore dhe kushtetuese të këtyre pretendimeve. Për më tepër, në rastin konkret ka mbetur pa përgjigje fakti se për zonën në fjalë nuk ka pasur çmime reference për ndërtime të llojit "shtëpi-muze", sikurse është planifikuar rindërtimi i pasurisë së kërkuesve. Parë nga ky këndvështrim, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk u ka siguruar kërkuesve aksesin efektiv të kërkuar. Për rrjedhojë, atyre u janë cenuar e drejta e aksesit substancial në gjykatë dhe standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje me garancinë e shpërblimit të drejtë.

34. Në kuadër të këtij vlerësimi, Gjykata evidenton se duke pasur në konsideratë natyrën subsidiare të kontrollit kushtetues të kërkesave individuale, ajo nuk shprehet për masën konkrete të shpërblimit, peshën e provave, statusin dhe destinacionin e pasurisë ose për zgjidhjen përfundimtare të çështjeve të zbatimit të ligjit. Në këtë kuptim, gjatë rishqyrtimit të çështjes, Gjykata e Lartë duhet të sigurojë shqyrtimin efektiv të pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekursin e kërkuesve.

35. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesve janë të bazuara pjesërisht, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-2077, datë 27.5.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 1.10.2026.
Shpallur më 30.10.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji
Anëtarë: Sonila Bejtja, Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

KËRKESË
Nr. 1194/4, datë 30.10.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i nënstacionit të ri 110/20 kV, Tiranë, Qendër", me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 4,971,037.75 (katër milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një mijë e tridhjetë e shtatë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekësh.

Subjekti kërkues i këtij projekti është "OSHEE Group" sh.a.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasurinë e llojit "truall" është bërë sipas pikës 4, të nenit 17, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", i ndryshuar; të ligjit nr. 104/2021, "Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e OSHEE-së për reagimin e krizës së pandemisë COVID-19"; të ligji nr. 62/2026, "Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e 'Nënstacionit të OSHEE-së Tiranë"', raport vlerësimi datë 2.3.2026.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë "OSHEE Group" sh.a., si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 4,971,037.75 (katër milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një mijë e tridhjetë e shtatë pikë shtatëdhjetë e pesë lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE PËR SHPRONËSIMIN E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I NËNSTACIONIT TË RI 110/20 kV, TIRANË, QENDËR"

Nr.	Pronari			Të dhëna hipotekore								Vlerësimet për shpronësim "Truall"			Vlera totale (lekë)	Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
	Emër	Atësi	Mbiemër	Qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Truall (m²)	Vol.	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lekë)		
A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	L	M	N	O	P	U	V
1	SHTET			Tiranë	8150	1/201	Truall	31.2	31.2	20	227	31.2	0	0	0	Me VKM-në nr. 810, datë 26.12.2018 bëhet shpronësimi në favor të shtetit të përfaqësuar nga Bashkia Tiranë.
2	Lindmar	Ymer	Gjinali	Tiranë	8150	1/568	Truall	24.5	24.5	65	30	24.5	202,899.50	4,971,037.75	4,971,037.75	Vjen nga pas. 1/492.
	Erlira	Kurtali	Gjinali													
3	SHTET			Tiranë	8150	1/401	Truall	26	26	39	169	26	0	0	0	Me VKM-në nr. 810, datë 26.12.2018 bëhet shpronësimi në favor të shtetit të përfaqësuar nga Bashkia Tiranë
4	SHTET			Tiranë	8150	1/212	Truall	32	32	23	99	32	0	0	0	Me VKM-në 810, datë 26.12.2018

														bëhet shpronësimi në favor të shtetit të përfaqësuar nga Bashkia Tiranë.
5	SHTET	Tiranë	8150	1/12	Truall	177.2	177.2	32	78	177.2	0	0	0	Me VKM-në 810, datë 26.12.2018 bëhet shpronësimi në favor të shtetit të përfaqësuar nga Bashkia Tiranë.
6	SHTET	Tiranë	8150	1/11	Truall	97	97	32	77	97	0	0	0	Me VKM-në 810, datë 26.12.2018 bëhet shpronësimi në favor të shtetit të përfaqësuar nga Bashkia Tiranë.
7	SHTET	Tiranë	8150	1/414	Truall	24	24	40	103	24	0	0	0	Me urdhër regjistruesi korrigjohet nr. i pasurisë për efekt përshëritje nga 1/405 në 1/414. Me VKM-në 810, datë 26.12.2018 bëhet shpronësimi në favor të shtetit të përfaqësuar nga Bashkia Tiranë. Pozicionimi ndryshon për efekt të saktësimit dhe korrigjimit të hartës me urdhër korrigjimi ref. 24845.
8	SHTET	Tiranë	8150	1/413	Truall	24	24	40	102	24	0	0	0	Me urdhër regjistruesi korrigjohet nr. i pasurisë për efekt përshëritje nga 1/406 në 1/413. Me VKM-në 810, datë 26.12.2018 bëhet shpronësimi në favor të shtetit të përfaqësuar nga Bashkia Tiranë.
9	SHTET	Tiranë	8150	1/494	Truall	61.8	61.8	47	121	61.8	0	0	0	Sipërfaqja dhe pozicionimi ndryshon për efekt të saktësimit dhe korrigjimit të hartës me urdhër korrigjimi ref. 24845.
10	SHTET	Tiranë	8150	1/554	Truall	206	206	62	147	51.1	0	0	0	Shpronësim në favor të shtetit përfaqësuar nga Bashkia Tiranë VKM-ja nr. 810/2018.
11	SHTET	Tiranë	8150	1/495	Truall	231	231	47	122	109	0	0	0	Me VKM-në 810, datë 26.12.2018 bëhet shpronësimi në favor të shtetit të përfaqësuar nga Bashkia Tiranë. U saktësua pozicionimi i kësaj pasurie me urdhër korrigjimi ref. 24845.
12	SHTET	Tiranë	8150	1/191	Truall	121.2	121.2	19	185	81	0	0	0	Shpronësim në favor të shtetit përfaqësuar nga Bashkia Tiranë. VKM-ja nr. 810/2018.
13	SHTET	Tiranë	8150	1/253	Truall	70	70	21	67	25.5	0	0	0	
14	SHTET	Tiranë	8150	1/364	Truall	71.6	71.6	34	230	70.65	0	0	0	Me VKM-në 810, datë 26.12.2018 bëhet shpronësimi në favor të shtetit të përfaqësuar nga Bashkia Tiranë.
15	SHTET	Tiranë	8150	1/559	Truall	254	254	63	75	96.2	0	0	0	Me VKM-në 810, datë 26.12.2018 bëhet shpronësimi në favor të shtetit të përfaqësuar

														nga Bashkia Tiranë.
16	SHTET	Tiranë	8150	1/249	Shesh	68.7	68.7	21	218	42	0	0	0	
17	SHTET	Tiranë	8150	1/386	Truall	131.2	131.2	41	51	32.3	0	0	0	Me VKM-në 810, datë 26.12.2018 bëhet shpronësimi në favor të shtetit të përfaqësuar nga Bashkia Tiranë.
18	SHTET	Tiranë	8150	1/211	Truall	106	106	22	228	93.1	0	0	0	Me VKM-në 810, datë 26.12.2018 bëhet shpronësimi në favor të shtetit të përfaqësuar nga Bashkia Tiranë.
19	SHTET	Tiranë	8150	1/8	Trotuar	677	0	29	43	15	0	0	0	
20	SHTET	Tiranë	8150	1/567	Truall	762.05	762.05	65	29	391.2	0	0	0	
21	SHTET	Tiranë	8150	1/561	Truall	67	67	63	77	42.2	0	0	0	Me VKM-në 810, datë 26.12.2018 bëhet shpronësimi në favor të shtetit të përfaqësuar nga Bashkia Tiranë.
22	SHTET	Tiranë	8150	1/378	Truall	32.68	32.68	36	213	9.4	0	0	0	
23	SHTET	Tiranë	8150	1/387	Truall	22.5	22.5	39	129	13.5	0	0	0	Me VKM-në 810, datë 26.12.2018 bëhet shpronësimi në favor të shtetit të përfaqësuar nga Bashkia Tiranë. Urdhër i drejtorit për kufizim.
24	SHTET	Tiranë	8150	1/386/2	Truall	63	63	49	109	63	0	0	0	Me VKM-në 810, datë 26.12.2018 bëhet shpronësimi në favor të shtetit të përfaqësuar nga Bashkia Tiranë. Urdhër i drejtorit për kufizim.
SHUMA PARAPRAKE													**4,971,037.75**	

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 272 lekë

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2026 - Numri: 239
Datë: 05.11.2026 15:08:58 +01:00
32d3ad4c-319f-4f49-a791-b09e3aecc9f1
Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)